



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI MBI AUDITIMIN E SISTEMEVE TË
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR NË BASHKINË SHKODËR

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

“MBI AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË
INFORMACIONIT NË BASHKINË SHKODËR”

Tiranë, Shtator 2021

PËRMBAJTJA

| Nr. | EMËRTIMI | Faqe |
|-------------|--|-----------|
| I. | PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE | 4 |
| 1. | Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit | 4 |
| 2. | Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve | 4 |
| 3. | Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit | 7 |
| II. | HYRJA | 8 |
| 1. | Objekti i auditimit | 8 |
| 2. | Qëllimi i auditimit | 8 |
| 3. | Identifikimi i çështjes | 8 |
| 4. | Përgjegjësitë e strukturave drejtuese | 9 |
| 5. | Përgjegjësitë e audituesve | 9 |
| 6. | Kriteret e vlerësimit | 9 |
| 7. | Standardet e auditimit | 10 |
| 8. | Metodat e auditimit | 10 |
| 9. | Dokumentimi i auditimit | 10 |
| III. | PËRSHKRIMI I AUDITIMIT | 11 |
| 1. | Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim | 11 |
| 2. | Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit | 12 |
| 2.1 | Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK | 12-24 |
| a | <i>Verifikimi i strategjisë, politikave dhe procedurave në TIK dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK</i> | |
| b | <i>Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve në TIK dhe në ofrimin e shërbimit</i> | |
| 2.2 | Auditimi i Sigurisë së Informacionit | 24-37 |
| a | <i>Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike dhe aksesit në rrjet</i> | |
| b | <i>Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit</i> | |
| 2.3 | Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit | 37-48 |
| a | <i>Identifikimi, hartimi i nevojave dhe kriterëve të vendosura për mallra dhe shërbime</i> | |
| b | <i>Procedurat e investimeve në fushën TIK</i> | |
| c | <i>Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit (Service Level Agreement)</i> | |
| 2.4 | Auditimi i Sistemeve | 48-54 |
| a | <i>Verifikim i kontrolleve të aplikacioneve për të dhënat Input/Output</i> | |
| b | <i>Kontrulli i shkallës së sigurisë së aplikacioneve, të drejtat e përdoruesve dhe menaxhimi i tyre</i> | |
| IV. | GJETJET DHE REKOMANDIMET | 55 |
| V. | ANEKSE | 65 |

⌘ LISTA E SHKURTIMEVE

| | |
|----------------|---|
| RSH | - Republika e Shqipërisë |
| KLSH | - Kontrolli i Lartë i Shtetit |
| INTOSAI | - Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit. |
| SAI | - Institucioni Suprem i Auditimit |
| AKSHI | - Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit |
| VKM | - Vendim i Këshillit të Ministrave |
| PBB | - Produkti i Brendshëm Bruto |
| TIK | - Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit |
| SHI | - Shoqëria e Informacionit |
| NJTIK | - Njësitë e Teknologjisë së Informacionit e të Komunikimit |
| DDOS | - Distributed Denial-of-Service |
| BE | - Bashkimi Evropian |
| GOVNET | - Government Network (Rrjeti qeveritar) |
| E-GOV | - Electronic Government |
| SSL | - Secure Sockets Layer |
| ASCYDA | - Automated System for Customs Data |
| MNSH | - Marrëveshje Nivel Shërbimi |
| TI (IT) | - Teknologji Informacioni |
| NJQV | - Njësia e Qeverisjes Vendore |
| SHI | - Shërbimi Informacioni |
| BCP | - Business Continuity Plan |
| BCC | - Business Continuity Center |
| DRC | - Disaster Recovery Center |
| OE | - Operator Ekonomik |
| PKI | - Public Key Infrastructure |
| IP | - Internet Protocol |
| VPN | - Virtual Private Network |
| KVO | - Komisioni i Vlerësimit të Ofertave |
| SiZ1N | - Sistemit të Integruar të Zyrës me Një Ndalesë |
| SiTTV | - Sistemi i integruar i Taksave dhe Tarifave Vendore |
| LAN | - Local area network |

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, datë 27.11.2014, zhvilloi një Auditim të Teknologjisë së Informacionit në Bashkinë Shkodër, nga data 18.05.2021 deri më datë 23.07.2021.

Grupi i auditimit mblodhi informacione, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë dhe mbështetur në to hartoi matricat e auditimit.

Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Projekti i auditimit, për auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, në Bashkinë Shkodër, është pjesë e Planit Vjetor 2021 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH. Projektimi i këtij auditimi, është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë që Bashkinë Shkodër disponon, për të garantuar disponibilitet dhe integritet të të dhënave.

Siguria e Informacionit është bërë gjithnjë e më shumë e rëndësishme për institucionet, kjo si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkë përdorimi i burimeve të informacionit. Siguria e Informacionit mund të përcaktohet si mundësia e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me termat e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë. Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij. Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: “Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TIK, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i asetëve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TIK, Menaxhimi i vazhdueshmërisë së biznesit, Përputhshmëria”.

I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Gjetjet kryesore, të paraqitura në këtë Raport Përfundimtar Auditimi në mënyrë të përmbledhur sipas drejtimeve të auditimit, rezultuan si më poshtë:

| Gjetja Nr. | Përmbledhje e Gjetjes | Referencat me Raportin Përfundimtar | Rëndësia | Rekomandimi |
|------------|--|-------------------------------------|----------|--|
| 1 | Nga auditimi u konstatua se bashkia Shkodër nuk ka strategji për teknologjinë e informacionit, mungesa e të cilës sjell mos planifikim dhe mos pasqyrim të qartë të objektivave lidhur me infrastrukturën IT dhe sigurinë institucionale si dhe burimet e nevojshme për matjen e objektivave. Mungesa e planit strategjik, mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së bashkisë. | faqe 12-24 | e lartë | Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni posedon dhe përpunon, të marrin masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të |

| | | | | |
|---|---|------------|---------|--|
| | | | | adresohen qartë objektivat e institucionit. |
| 2 | Nga auditimi u konstatua se funksionimi dhe organizimi i strukturës së IT-së në nivel sektori nën Drejtorinë e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse, nuk i përgjigjet shtrirjes së teknologjisë së informacionit në bashki dhe njësitë të vartësisë duke sjellë uljen e ndikimit të IT-së në qeverisjen e bashkisë si dhe zbeh ndikimin e varësisë direkt nga menaxhimi i lartë. | faqe 12-24 | e lartë | Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme të analizojnë mundësinë e ndryshimeve strukturore të strukturës ekzistuese IT me qëllim rritjen e rolit të saj dhe të marrin masa për ngritjen në nivel të strukturës së IT nga nivel sektori në nivel Drejtorie. |
| 3 | Referuar pikave kryesore të sigurisë së informacionit në rrjetin privat dhe publik janë verifikuar konfigurimet e sigurisë mbi switch-et dhe firewall-in e institucionit, dhe nga verifikimi rezultoi se: -Rrjeti i bashkisë nuk është i ndarë në rrjet privat dhe në rrjet publik (internet); -Për konfigurimet aktuale për switch-et kryesore, nuk janë marrë masat e nevojshme që useri admin të limitohet në logimin vetëm nga IP-të brenda rrjetit privat dhe nuk është e bllokuar që useri admin të logohet nga jashtë rrjetit, pra nga një rrjet publik; -Nuk janë krijuar zona me limite të caktuara për brenda LAN si dhe rrjeti nuk është i ndarë në VLAN (rrjete virtuale) çka do të bënte të mundur menaxhimin dhe lejimin e grupeve të IP-ve në shërbime të ndryshme sipas nevojave. Gjithashtu nuk është krijuar edhe një zonë Untrust e cila sipas konfigurimeve shërben për bllokimin e portave të shërbimeve si dhe bllokimin e IP-ve të cilat mund të paraqesin problematika ose sulme; -Pajisjet switch aksesohen në çdo moment në qoftë se je lidhur në rrjetin e bashkisë dhe aksesimi i tyre realizohet me të njëjtat kredenciale të njëllajta. Kjo gjë do të rrit mundësinë për sulme nga scripture/viruse; -Koha e vendosur tek të gjitha switchet është manuale duke mos treguar kohën dhe datën reale të ndodhjes së një problematike, duke ndikuar në të dhënat e logeve, pasi çdo log dhe gjurmë e dokumentuar nuk ka të dhëna të sakta se çfarë date/ore ka ndodhur; -Për administrimin e firewall nuk janë krijuar group users me nivele të ndara menaxhim/monitorim. Çdo veprim bëhet nga useri admin. | faqe 24-37 | e lartë | Spektori TIK pranë bashkisë Shkodër të marrë masat e nevojshme për krijimin e konfigurimeve përkatëse në rrjetin e institucionit mbi logimin, konfigurimin dhe sigurinë e switch-ve dhe firewall-it. Të krijohen zona me limite të caktuara brenda LAN si dhe rrjeti të konfigurohet në VLAN (rrjete virtuale) për menaxhimin dhe lejimin e grupeve të IP-ve në shërbime të ndryshme sipas nevojave. Gjithashtu të merren masa për administrimin dhe implementimin e të gjitha konfigurimeve të nevojshme të evidentuara nga auditimi dhe të tjera të mundshme, me qëllim rritjen e sigurisë së infrastrukturës network. |
| 4 | Nga auditimi u konstatua se bashkia Shkodër nuk disponon një politikë/rrregullore të dokumentuar dhe miratuar për procesin e menaxhimit të përdoruesve (krijimi, fshirja, ndryshimi i roleve/të drejtave, ndryshimi i fjalëkalimeve etj.) për sistemet SZIN dhe SiTTV. Bashkia Shkodër nuk disponon bazë rregullatore në lidhje me menaxhimin e të dhënave, të drejtat dhe menaxhimin e përdoruesve të Sistemit të Integruar të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe të Sistemit të Zyrës me Një Ndalesë. | faqe 48-54 | e lartë | Rekomandimi 1: Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër të marrin masa për hartimin dhe miratimin e rregulloreve përkatëse për funksionimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit të cilët ka në përdorim institucioni, në të cilat të jenë të pasqyruara saktë përgjegjësitë, detyrat dhe të drejtat për menaxhimin e përdoruesve të këtyre sistemeve. Në rregullore të përcaktohet edhe politika për menaxhimin e gabimeve njerëzore dhe teknike në lidhje me |

| | | | | |
|---|--|------------|---------|---|
| | | | | <p>përdorimin e sistemeve të IT.</p> <p>Rekomandimi 2: Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër të marrin masa për përcaktimin e administrator-it/ëve të sistemeve të teknologjisë së informacionit që Bashkia Shkodër ka në përdorim. Detyrat, përgjegjësitë dhe të drejtat e administratorit të sistemeve IT përcaktohen në rregulloren përkatëse të sistemit.</p> |
| 5 | <p>Nga auditimi i bazës së të dhënave të Sistemit të Integruar të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Sistemit të Zyrës me Një Ndalesë u konstatua se këto dy sisteme kanë nevojë për përmirësime në drejtim të garantimit të integritetit dhe plotësisë së të dhënave që krijohen, menaxhohen dhe ruhen përmes tyre. Më konkretisht:</p> <p>-Në Sistemin e Integruar i Taksave dhe Tarifave Vendore, janë konstatuar 5 problematika në lidhje me plotësinë e të dhënave përgjatë popullimit të tabelave dhe fushave;</p> <p>-Në Sistemin e Zyrës me Një Ndalesë janë konstatuar 4 problematika: në lidhje saktësinë e fushave të populluara; në lidhje me statusin e aplikimeve për marrjen e shërbimeve; në lidhje me plotësinë e fushave, etj.</p> | faqe 48-54 | e lartë | <p>Struktura e teknologjisë së informacionit, të marrë masa për analizimin e situatës aktuale në lidhje me integritetin dhe plotësinë e të dhënave që përmbajnë sistemet informatike të Bashkisë Shkodër duke përcaktuar edhe shkaqet prej të cilëve rrjedhin problematikat e konstatuara. Të merren masat e nevojshme për ngritjen dhe implementimin e mekanizmave të kontrollit dhe validimit të inputit të sistemeve informatike, duke përcaktuar dhe kornizuar tipin e të dhënave që mund të plotësojnë përdoruesit në përputhje me formatin dhe informacionin që përmban secila prej fushave, me qëllim parandalimin e përsëritjes së problematikave të konstatuara.</p> |

I.3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit:

Grupi i auditimit mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH” datë 27.11.2014 konstaton se, mungesa e strategjisë në drejtim të teknologjisë informacionit, mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së bashkisë. Në gjykimin tonë, identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në ofrimin shërbimeve dhe garantimin e sigurisë së të dhënave si dhe vazhdimësisë në ofrimin e shërbimit nëpërmjet teknologjisë së informacionit është i pa pamjaftueshëm. Në këtë drejtim, përdorimi i sistemeve në bashki mbart një risk të lartë në mbarëvajtjen e funksionaliteteve të ndërtuara në shërbim të qëllimit dhe objektivave institucionale.

Mungesa e akteve rregullatorë në drejtim të sistemeve të teknologjisë së informacionit kanë ndikuar në një zhvillim të pa monitoruar të aktivitetit institucional dhe pa deleguar përgjegjësitë individuale për veprimet e kryera. Investimet në sistemet e informacionit nuk kanë zgjidhur përfundimisht problemet e sigurisë së informacionit, sigurimin e vazhdueshmërisë së biznesit. Zhvillimi i shërbimeve dhe infrastrukturës duhet të mbështetet në praktikat më të mira si dhe në rekomandimet e AKSHIT.

Bashkia Shkodër nuk ndjek një politikë të përcaktuar për analizimin e gjurmëve të auditimit për veprimet që kryejnë përdoruesit në sisteme. Bashkia Shkodër nuk disponon një politikë/rregullore të dokumentuar dhe miratuar për procesin e menaxhimit të përdoruesve (*krijimi, fshirja, ndryshimi i roleve/të drejtave, ndryshimi i fjalëkalimeve etj*) për sistemet që disponon.

Zbatimi i rekomandimeve të këtij raporti si dhe mbështetja e zhvillimit të TI në bashki nga strukturat përfaqësuese dhe ekzekutive të bashkisë do të rris stabilitetin dhe do të sigurojë qeverisjen efektive dhe në mbështetje të qytetarëve.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH*”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 552/1, datë 02.06.2021 të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi 18.05.2021 deri në 23.07.2021, në Bashkinë Shkodër, ku periudha e audituar është 01.01.2019 deri në 31.12.2020, u krye auditimi mbi “*Auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit*”, me Grup Auditimi të përbërë nga:

1. B.H, Përgjegjës Grupi
2. A.K, Anëtar
3. E.K, Anëtar
4. R.A, Anëtar

II.1. Objekti i auditimit:

Objekti i Auditimit TIK ushtruar në Bashkinë Shkodër, është përcaktimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrën e duhur duke përdorur burimet IT, përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullatorë, konfidencialitetit, integritetin si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

Përcaktimi nëse sistemet e teknologjisë së informacionit në Bashkinë Shkodër, mbrojnë asetet e informacionit; ruajnë integritetin e të dhënave; sigurojnë disponueshmërinë dhe konfidencialitetin e informacionit dhe mbështeten në kontrolle të duhura.

II.2. Qëllimi i auditimit:

Qëllimi i Auditimit TIK ushtruar në Bashkinë Shkodër, është dhënia e opinionit apo vlerësimi nëse ekzistojnë kontrollet dhe mekanizmat e duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen, zhvillimin e burimeve IT dhe funksioneve për të cilat këto burime shërbejnë.


Objektivat e këtij projekt auditimi, u vendosën në koherencë me veprimtarinë, vizionin, qëllimin dhe objektivat e bashkisë, duke marrë në konsideratë të gjithë kuadrin rregullator në bazë të të cilit institucioni zhvillon veprimtarinë e tij. Për të arritur në dhënie të një opinionit, janë mbledhur informacione, të dhëna dhe prova, për të përcaktuar nëse nëpërmjet teknologjisë së informacionit mbrohen asetet, ruhet integriteti i të dhënave, si dhe synimet e subjektit që auditohet arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet në mënyrë efikente.

II.3. Identifikimi i çështjeve:

Pas marrjes së informacionit nga subjekti nëpërmjet pyetësorit të dërguar në mënyrë elektronike dhe përpunimit të tij nga grupi i auditimit, analizës së riskut nëpërmjet manualit aktiv të auditimit IT, si dhe vlerësimin e informacioneve nga burime të jashtme, kanë rezultuar si fusha me risk më të lartë:

1. Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK.
2. Auditimi i Sigurisë së Informacionit.
3. Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit.
4. Auditimi i Sistemeve.
5. Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

II.4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:



Bashkia Shkodër bën pjesë në Qarkun Shkodër e cila përbëhet nga një qendër bashkie qyteti Shkodër i përberë nga 5 lagje dhe 11 njësi administrative me një total prej 93 fshatra.

Organizimi administrativo-territorial i Bashkisë Shkodër bazohet në ligjin nr.115/2014 “Për ndarjen administrative-territorial të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Qeverisja vendore ndahet në dy nivele: niveli i parë në të cilën bëjnë pjesë bashkitë dhe niveli i dytë në të cilët bëjnë pjesë qarqet.

Në zbatim të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve, organizon dhe drejton punën e administratës për kryerjen e funksioneve të Bashkisë. Në nenin 3 dhe 4 të ligjit të qeverisjes vendore janë të përcaktuara Misioni i vetëqeverisjes vendore dhe parimet e tij.

Bashkia Shkodër ka për misionin që të sigurojë qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve. Të drejtat dhe përgjegjësitë përcaktohen mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Në nenin 7 të tij përcaktohen Organet e njësisve të vetëqeverisjes vendore të cilët përbëhen nga: Organi përfaqësues i bashkisë, i cili është Këshilli Bashkiak dhe Organi ekzekutiv i bashkisë i cili është Kryetari i Bashkisë.

Kryetari i Bashkisë, ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të Bashkisë, me përjashtim të atyre që janë kompetencë vetëm e Këshillit Bashkiak;

Kryetari i Bashkisë, miraton strukturën organike të Bashkisë dhe miraton rregulloret e funksionimit të saj, si dhe përshkrimet e punës për pozicionet e punës në administratën e Bashkisë.

II.5. Përgjegjësitë e audituesve:

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Bashkinë Shkodër, mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2019 deri në 31.12.2020, duke i kushtuar vëmendje çështjeve që lidhen me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë si dhe standardeve ndërkombëtare të teknologjisë dhe auditimit TIK. Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban Programi i Auditimit nr. 552/1, datë 02.06.2021 miratuar nga Kryetari i KLSH. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, si dhe legjislacionin e fushës në të cilën operon Bashkia Shkodër. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese, është siguruar një evidencë e përshtatshme, e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

II.6. Kriteret e vlerësimit:

Kriteret e vlerësimit bazohen në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet e përcaktuara nga AKSHI si dhe ato ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit, Manuali i Teknologjisë së Informacionit. Opinionet dhe konkluzionet e nxjerra nga auditimi janë mbështetur në Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit, janë

dokumentuar në aktet e mbajtura. Gjithashtu janë lënë rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

Hartimi i këtij projekt raporti, mbështetet në bazën ligjore si më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165);
- Ligji nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe aktet ligjore në zbatim të tij;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”;
- Legjislacioni mbi Krimin Kibernetik;
- Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10325, datë 23.09.2010, “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”;
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

II.7. Standardet e auditimit:

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik, Standardet, dhe teknika auditimi, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testime dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë, duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të TIK, si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310, etj.

II.8. Metodat e auditimit:

Grupi i auditimit, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit, ka përdorur metoda si intervista me gojë dhe me shkrim ndaj subjektit të audituar, verifikimin e zbatimit të kontratave të marrëveshjeve në nivel shërbimi në varësi të rëndësisë dhe vlerës monetare, ka verifikuar dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar dhe të paraqitur nga subjekti i audituar me qëllim përmbushjen e drejtimeve të auditimit, ka testuar me teknikat CAAT të dhënat e sistemeve, si dhe ka kryer testime dhe verifikime mbi shkallën e sigurisë së rrjetit dhe sistemeve që subjekti i audituar përdor.

II.9. Dokumentimi i auditimit:

-Për çështjen e auditimit “*Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK*”, grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin: Dokumenti strategjik “Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Shkodër për vitet 2015-2030”; Rregullorja e brendshme e administratës; Struktura e përgjithshme organizative të miratuar të institucionit; Lista e të gjithë punonjësve në IT sipas kategorisë, hierarkisë, pozicionit të punës në strukturë si dhe përshkrimet e punës sipas akteve rregullative në fuqi; Lista e trajnimeve të organizuara nga ASPA; Manual Përdorimi “Për shqyrtimin e shërbimeve administrative nëpërmjet Sistemit të Integruar të Zyrës me Një Ndalesë (SiZ1N)”; Manual mbi raportet për Sistemin e Integruar të Zyrës me një Ndalesë; Manual përdorimi mbi Sistemi i Taksave; Manual përdorimi i Sistemit të Shërbimeve Sociale Rajonale; Rregulloren “Për shërbimet administrative në Bashkinë Shkodër; Regjistri i riskut institucional; Gjithashtu grupi i auditimit mblodhi informacione duke zhvilluar pyetësorë e intervista me stafin e bashkisë Shkodër dhe mbi informacionin e mbledhur u zhvilluan analizime; etj.

-Për çështjen e auditimit “*Auditimi i sigurisë së informacionit*”, grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin: Politikat e sigurisë së informacionit; Aktet e brendshme mbi sigurinë e informacionit; Elementët e sigurisë të implementuara deri në momentin e auditimit mbi aksesin

e punonjësve në sisteme dhe në ambientet fizike; Verifikime onsite të dhomës së serverave të Bashkisë dhe networkut të institucionit; Skema e komunikimit të network-ut; Konfigurimet mbi switch-et dhe firewall; Procedurat për backup-in e të dhënave; Verifikimi e dokumentimi i planeve për vazhdueshmërinë e biznesit dhe rimëkëmbjes nga katastrofat; Konsultim me faqen e webit dhe pen test mbi faqen web të bashkisë; etj.


-Për çështjen e auditimit “*Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit*”, grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin: Mbi procedurat e investimeve në fushën TIK; Marrëveshjet në nivel shërbimi (u shqyrta zbatimi i MNSH në lidhje me raportet dhe me kërkesat kontraktuale), etj.

-Për çështjen e auditimit “*Auditimi i Sistemeve*”, grupi i auditimit dokumentacionin dhe të dhënat: Përshkrim i përgjithshëm i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Bashkinë Shkodër; Lista e përdoruesve në Sistemin e Zyrës me Një Ndalesë; Lista e përdoruesve në Sistemin e integruar të Taksave dhe Tarifave Vendore; Lista e përdoruesve në Sistemin e Shërbimeve Sociale; Struktura e Bashkisë Shkodër për vitet 2019, 2020, 2021; Rregullore ‘Shërbimet Administrative në Bashkinë Shkodër’, miratuar me Vendimin Nr. 383, Datë 28.05.2016; Manuali i përdoruesit të Sistemit të Taksave dhe Tarifave Vendore; Manual i përdoruesit të Sistemit të Shërbimeve Sociale; Manual për përdorimin e raporteve të Sistemit të Zyrës me Një Ndalesë; Manual i përdoruesit të Sistemit të Zyrës me Një Ndalesë; U mor akses me përdorues me të drejta “Audit” në SZIN dhe SiTTV; Backup i plotë i bazës së të dhënave të SZIN dhe SiTTV.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III.1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Bashkia Shkodër shtrihet në veriperëndim të Shqipërisë me një territor prej 873 km², dhe kufizohet në veri me Bashkinë e Malësisë së Madhe, në perëndim me Malin e Zi, në lindje me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Vau i Dejës dhe me Bashkinë Lezhë.



Bashkia e Shkodrës përbëhet nga 11 njësi të qeverisjes vendore, (Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postribë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh dhe Velipojë).

Qyteti i Shkodrës ndodhet në veriperëndim të Shqipërisë. Në veriperëndim të tij ndodhet Liqeni i Shkodrës, i cili me një sipërfaqe prej 368 km² është liqeni më i madh në Ballkan. Nga ky liqen buron Lumi Buna (44 km), i cili derdhet në detin Adriatik dhe rrjedha e poshtme e te cilit ndan kufirin me Malin e Zi. Lumi Buna bashkohet me lumin Drin rreth 2 km në jugperëndim të qytetit.

Nga ana lindore qyteti kufizohet me Lumin Kir, i cili buron nga Malësitë e Veriut dhe është 43 km i gjatë. Ky lum derdhet në Lumin Drin që rrethon Shkodrën nga ana jugore.

Pjesa kryesore fushore e qytetit sot ka një shtrirje prej 1,150 ha, ndërsa pjesa kodrinore ka një shtrirje prej 350 ha.

Misioni

Bashkia Shkodër ka për misionin që të sigurojë qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve. Të drejtat dhe përgjegjësitë përcaktohen mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Demografia

Me reformën e re territoriale, popullsia e Bashkisë së Shkodrës është dyfishuar. Aktualisht kjo bashki ka një popullsi prej 204,954 banorë. Përqendrimi më i madh i popullsisë është në qytetin e Shkodrës me 55% të popullsisë (114,085 banorë), ndërsa për sa i përket njësive administrative, njësia me popullsi më të madhe është ajo e Rrethinave me 23,923 banorë. Njësitë e tjera më të mëdha nisur nga numri i popullsisë janë: Guri i Zi me 11,838 banorë, Postriba me 11,730 banorë, Bërdica me 9,655 banorë, Velipoja me 9,574 banorë dhe Dajçi me 8,998 banorë. Tre njësitë e tjera më të vogla për nga numri i popullsisë janë Ana e Malit me 5,968 banorë, Pulti me 3,249 banorë, si dhe Shalë e Shosh me 5,934 banorë.

Organizimi administrativo-territorial i Bashkisë Shkodër bazohet në ligjin nr.115/2014 “Për ndarjen administrative-territorial të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”. Qeverisja vendore ndahet në dy nivele: niveli i parë në të cilën bëjnë pjesë bashkitë dhe niveli i dytë në të cilët bëjnë pjesë qarqet. Në zbatim të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve, organizon dhe drejton punën e administratës për kryerjen e funksioneve të Bashkisë. Në nenin 3 dhe 4 të ligjit të qeverisjes vendore janë të përcaktuara Misioni i vetëqeverisjes vendore dhe parimet e tij. Në nenin 7 të tij përcaktohen Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore të cilët përbëhen nga:

Organi përfaqësues i bashkisë, i cili është Këshilli Bashkiak dhe Organi ekzekutiv i bashkisë i cili është Kryetari i Bashkisë.

Kryetari i Bashkisë, ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të Bashkisë, me përjashtim të atyre që janë kompetencë vetëm e Këshillit Bashkiak;

Kryetari i Bashkisë, miraton strukturën organike të Bashkisë dhe miraton rregulloret e funksionimit të saj, si dhe përshkrimet e punës për pozicionet e punës në administratën e Bashkisë.

Gjatë viteve të fundit, Bashkia Shkodër ka implementuar disa sisteme informacioni të integruara me qëllim ofrimin e shërbimeve elektronike ndaj qytetarëve, rritjen e shkallës së përdorimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit për ofrimin e këtyre shërbimeve, uljen e kostove dhe përmirësimin e cilësisë, rritjen e të ardhurave vendore dhe menaxhimin e tyre, përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies, identifikimin e shtresave sociale dhe shërbimeve që marrin, etj.

III.2. PËRSHKRIM I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT:

III.2.1. Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK

a. Verifikimi i strategjisë, politikave dhe procedurave në TIK dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK:

➤ Verifikimi i strategjisë TIK

Dokumenti strategjik i administruar nga grupi i auditimit është “Plani i Përgjithshëm Vendor¹ i Bashkisë Shkodër për vitet 2015-2030”. Sipas përcaktimeve të këtij dokumenti, ky Plan i Përgjithshëm i Bashkisë, formon dokumentin bazë mbi të cilin do të hartohet Planin i Përdorimit të Tokës dhe Rregullorja e Zhvillimit. Strategjia ka si qëllim:

- Të ofrojë një vizion dhe drejtim konsistent, si dhe një vlerësim strategjik jo vetëm të asaj çka është e dëshirueshme, por edhe asaj që është e mundshme në kontekste të ndryshme.

¹ *i emërtuar “Strategjia territoriale, vizioni strategjik, objektivat e zhvillimit”.

- Të mbrojnë të drejtat e njerëzve. Në momentin që njerëzit kanë akses në tokë, në fakt ata marrin disa të drejta dhe obligime. Është e nevojshme që të menaxhohet ndryshimi në mënyrë të tillë që të drejtat dhe obligime të respektohen.
- Të mbrojnë sistemet natyrore. Sistemet natyrore kanë kërkesat e tyre operacionale të cilat duhet të respektohen për të mbrojtur qëndrueshmërinë afat-gjatë të zhvillimit njerëzor dhe nëse duam të evitojmë degradimin mjedisor në shkallë të madhe.
- Të arrijë një përdorim eficient të burimeve, si toka, uji, energjia, financat, materialet e ndërtimit, aftësitë etj.
- Të arrijë një cilësi të lartë të ofrimit të shërbimeve nga të gjitha sferat e qeverisjes.
- Të koordinojë veprimet dhe investimet: që të sigurojë impaktin pozitiv maksimal nga investimi i burime, është e nevojshme që investimet të koordinohen në hapësirë dhe në kohë. Ky koordinim mund të jetë dy llojesh: koordinimi i formave të ndryshme të veprimeve dhe investimit nga autoritetet publike; si dhe një koordinim midis veprimeve publike dhe private;
- Të vendose prioritete. Të mundësojë krijimin “e rrugëve” të ndërmjetme që nevojat për zhvillim të një vendi të arrihen në mënyra të drejta.
- Të evitojë dublikimin e përpjekjeve nga departamente dhe sfera të ndryshme të qeverisjes.

Disa nga objektivat strategjik të përcaktuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër në lidhje me elementë të Teknologjisë së Informacionit janë:

- *Programi Strategjik OS2PS3: Qendrat me një Ndalesë dhe Ngritja e Kapaciteteve Lokale.*

Ky program synon ngritjen e kapaciteteve lokale dhe formimin e qendrave me një ndalesë në mënyrë që të përmirësohen sa më shumë shërbimet administrative në ndihmë të komuniteteve.

Kjo gjë do të arrihet nëpërmjet politikave të mëposhtme:

o Zgjerimit të shërbimit të Internetit në të gjithë zyrat e qendrave administrative

o Ofrimi i Shërbimit me një ndalesë

o Trajnimeve

Shërbimi me një ndalesë

Ky shërbim mund të ofrohet më vete, pra në zyrat e njesisë administrative, dhe/ose në bashkëpunim me zyra të tjera si posta/policia/shkolla etj në varësi të kapaciteteve dhe institucioneve ekzistuese lokale. Në këtë kontekst zyrat me një ndalesë mund të luajnë edhe role këshillimore ndaj qytetarëve të tilla si:

o Informacion/Guida turistike

o ‘Arkitekti Im’

- *Programi Strategjik OS2PS4: Qeverisja Elektronike*

Bashkia Shkodër synon të rrisë transparencën ndaj publik dhe të përmirësojë shërbimet duke modernizuar dhe dixhitalizuar një sërë shërbimesh të cilat lidhen me Bashkinë. Në këtë kontekst do të ofrohen shërbime dixhitale për bizneset me anë të të cilave mund të kryhen veprimet për pagimet e taksave.

Gjithashtu, me të njëjtën logjikë më pas do të dixhitalizohet edhe shërbimi për qytetarin duke u bazuar në një Portal unik në të cilin mund të merren informacion si dhe të merren shërbime e kryhen veprime të ndryshme. Portali do të jetë i përdorshëm për “telefonat inteligjent” si dhe në versionin e një faqeje interneti.

Nga auditimi u konstatua se:

-Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Shkodër për vitet 2015-2030 nuk përcakton politika shteruese për veprimtarinë mbi Teknologjinë e Informacionit. Kjo strategji është hartuar si një strategji ndërsektoriale gjithëpërfshirëse e Bashkisë në nivel makro. Ky dokument strategjik nuk është update-uar me ndryshimet që ka pësuar Bashkia për një periudhë 6 vjeçare në lidhje me teknologjinë e informacionit.

Nga auditimi mbi masat e marra për plotësimin objektivave të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë 2015-2030 u konstatua se nuk ka indikatorë të matshëm për plotësimin e këtyre objektivave.

Në masat Planin e Përgjithshëm bëhet një shpjegim i përgjithshëm narrativ në nivel makro i politikave mbi situatën dhe nuk flitet për element konkret dhe mënyrën se si do të arrihet përmbushja e këtyre objektivave.

Gjithashtu, duke patur parasysh që Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë është hartuar për një periudhë 15 vjeçare do të ishte e nevojshme hartimi i një plan-veprimi për strategjinë si dhe përcaktimin e indikatorëve të matjes së performancës së strategjisë.

-Bashkia Shkodër nuk ka një Plan Strategjik të shkruar e miratuar për Teknologjinë e Informacionit duke mos bërë planifikime strategjike mbi sigurinë institucionale dhe infrastrukturën IT si dhe duke mos pasqyruar qartë objektivat lidhur me burimet dhe instrumentet e nevojshme për matjen e objektivave. Mungesa e Planit Strategjik, mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Bashkisë.

➤ *Verifikim i politikave dhe procedurat në TIK*

Grupi i auditimit, me qëllim auditimin e nivelit të dokumentimit të politikave dhe procedurave në lidhje me teknologjinë e informacionit në Bashkinë Shkodër, verifikoi Rregulloren e Brendshme të institucionit si dhe udhëzime të tjera të brendshme. Auditimi për këtë çështje, pati në konsideratë risqet që vijnë nga mungesa e politikave dhe procedurave të shkruara si dhe nga praktikat me të cilat institucioni zhvillon aktivitetin e tij.

Nisur nga rëndësia që sistemet e informacionit kanë për realizimin e skemës së mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore, Bashkia Shkodër për vitet 2019-2020 nuk ka pasur një rregullore të përgjithshme për teknologjinë e informacionit në institucion.

Aktualisht, institucioni e ushtron aktivitetin e tij mbështetur në rregulloren “Për organizmin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Shkodër”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 20.03.2017 të Kryetarit të Bashkisë.

Nga auditimi u konstatua se, Rregullorja e Brendshme, “Për miratimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Shkodër” miratuar me vendimin nr. 96, datë 20.03.2017 të Kryetarit të Bashkisë nuk është përshtatur (*amenduar*) duke mos reflektuar ndryshimet institucionale të ndodhura ndër vite në Bashkinë Shkodër.

Në rregullore përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë duke ju referuar sektorit të administrimit të sistemeve dhe menaxhimit të zyrës së integruar me një ndalesë, por nuk përmenden fare Përgjegjësit, specialistët për sistemet e tjera si “Sistemi i Taksave dhe Tarifave Vendore; Sistemi i Shërbimit Social; Transparenca e Buxhetit”. Të gjithë këto sisteme nuk janë të reflektuar në Rregulloren e Brendshme duke mos përcaktuar elementë përkatës për të siguruar funksionim të përshtatshëm të strukturës IT në institucion.

Gjatë fazës së auditimit në terren grupi i auditimit administroi një sërë rregulloresh të tjera nga ku u konstatua se institucioni administron dhe ka në përdorim një bazë rregullative mbi sistemet i përket mënyrës së përdorimit të tyre, të përfituara gjatë implementimit të sistemeve, nga ku mund të përmendim:

Manuale të aplikacioneve:

- Manual Përdorimi “*Për shqyrtimin e shërbimeve administrative nëpërmjet Sistemit të Integruar të Zyrës me Një Ndalesë (SiZIN)*”;
- Manual mbi raportet për Sistemin e Integruar të Zyrës me një Ndalesë;
- Manual përdorimi mbi Sistemi i Taksave;
- Manual përdorimi i Sistemit të Shërbimeve Sociale Rajonale;

- Rregulloren “Për shërbimet administrative në Bashkinë Shkodër”, miratuar me vendimin nr. 283, datë 20.05.2016, të Kryetarit të Bashkisë.

Kjo rregullore ka për qëllim të sigurojë realizimin efektiv të procedurave administrative në funksion të ofrimit të shërbimeve qytetarëve në mënyrë cilësore, në kohë më të shkurtër dhe kosto më të ulët duke zbatuar parimin e procesit të rregullt ligjor me anë të ofrimit të shërbimeve administrative përmes, Sistemit të Integruar së Zyrës me Një Ndalesë.

➤ *Vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK*

Qeverisja vendore ndahet në dy nivele: niveli i parë në të cilën bëjnë pjesë bashkitë dhe niveli i dytë në të cilët bëjnë pjesë qarqet. Në zbatim të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve, organizon dhe drejton punën e administratës për kryerjen e funksioneve të Bashkisë. Në nenin 3 dhe 4 të ligjit të qeverisjes vendore janë të përcaktuara Misioni i vetëqeverisjes vendore dhe parimet e tij. Në nenin 7 të tij përcaktohen Organet e njësisve të vetëqeverisjes vendore të cilët përbëhen nga:

Organi përfaqësues i bashkisë, i cili është Këshilli Bashkiak dhe Organi ekzekutiv i bashkisë i cili është Kryetari i Bashkisë.

Kryetari i Bashkisë, ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të Bashkisë, me përjashtim të atyre që janë kompetencë vetëm e Këshillit Bashkiak;


Kryetari i Bashkisë, miraton strukturën organike të Bashkisë dhe miraton rregulloret e funksionimit të saj, si dhe përshkrimet e punës për pozicionet e punës në administratën e Bashkisë.

Struktura e Bashkisë Shkodër për vitin 2019, është e miratuar me Vendimin Nr. 6, datë 03.01.2019, të Kryetarit të Bashkisë.

Struktura e Bashkisë Shkodër për vitin 2020, është e miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 20.01.2020, të Kryetarit të Bashkisë. Organizimin dhe rekrutimin e punonjësve e realizon bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, VKB “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë dhe punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe të institucioneve në varësi të Bashkisë Shkodër”. Numri i përgjithshëm i punonjësve të Bashkisë Shkodër është gjithsej 986 punonjës (pa përfshirë këtu punonjësit me kontratë).

Për kryerjen e funksioneve, përgjegjësive, bashkia ka një strukturë organizative e cila është e ndërtuar mbi bazën e Drejtorive, sektorëve dhe njësisve të varësisë dhe veprimtaria e të cilave rregullohet nëpërmjet dokumenteve të statutit dhe rregullores së Bashkisë.

Figura nr. 1: Në figurën e mëposhtme paraqitet struktura organike e Bashkisë Shkodër




Burimi: Subjekti i auditimit.

Sektori i Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të Z1N, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit është pjesë përbërëse e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse e cila ka si detyrë:

- menaxhimi i sistemeve TIK;
- menaxhimi teknik - auditues / përgjegjës cilësie;
- shërbimi dhe funksionimi – administrator i sistemeve;
- mbështetës – trajnues i TIK.

Aktivitetin e saj kryesor sektori i Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të Z1N, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit e ka mbështetur në rregulloren “Për organizmin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Shkodër”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 20.03.2017 të Kryetarit të Bashkisë.

Struktura aktuale e sektorit të Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të Z1N, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit është e përbërë nga 20 punonjës (plan), një Përgjegjës Sektori, 4 Specialist të TIK, help desk, etj dhe Zyra me Një Ndalesë e përbërë nga 15 Specialist si më poshtë:



| Nr. | Sektori i Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të Z1N, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit | Nr. plan | Nr. Fakt |
|-----|--|-----------|-----------|
| | <i>Përgjegjës Sektori</i> | 1 | 0 |
| 1. | Specialist të TIK, Help Desk, etj. | 4 | 4 |
| 2. | Zyra me Një Ndalesë | | |
| | Specialist për statistikat | 15 | 13 |
| | Totali | 20 | 17 |

Struktura e burimeve njerëzore në Sektori i Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të Z1N, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit është e paplotësuar sipas strukturës organike të përcaktuar (*vendi i përgjegjësit të sektorit është vakant dhe dy vende specialist në zyrën me një ndalesë janë të paplotësuara*). Ndërprerja e marrëdhënieve të punës për ish Përgjegjës të Sektorit, ka ardhur si rezultat i kërkesës së saj për tu larguar. Nuk rezultoi të ketë ka patur lëvizje, pushime apo transferime nga puna.

Nga auditimi u konstatua se për punonjësit e sektorit të Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të Z1N, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit nuk janë hartuar dhe miratuar përshkrimet e punës si dhe kriteret për kualifikimet e punonjësve për këtë sektor. Përshkrimet e punës që gjenden në dosjen individuale të çdo specialisti të këtij sektori janë marrë nga rregullorja e brendshme e Bashkisë, duke mos përcaktuar qartësisht përgjegjësitë dhe detyrat e gjithsecilit në proceset e punës.

Duke vlerësuar rëndësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore në Bashkinë Shkodër nga auditimi u konstatua se:

-Nisur nga objektivat e Bashkisë Shkodër, nga shtrirja e teknologjisë së informacionit në institucion si dhe nga rëndësia e të dhënave që ruhen dhe përpunohen nga sektori i Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të Z1N, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit për mbledhjen e taksave në Bashkinë Shkodër me anë të sistemit të informacionit (SiTTV) për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore si dhe menaxhimin e tyre dhe ofrimit të shërbimeve me anë të sistemit informatik “Sistemi i integruar i Zyrave me Një Ndalesë (SiZIN)”, grupi i auditimit gjykon që organizimi i strukturës së IT-së në nivel sektori

nën Drejtorinë e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse, nuk i përgjigjet shtrirjes së teknologjisë së informacionit në Bashki dhe institucionet e vartësisë duke sjellë uljen e ndikimit të IT-së në qeverisjen e Bashkisë si dhe zbeh ndikimin e varësisë direkt nga menaxhimi i lartë.

➤ **Trajnimet**

Trajnimi është një nga shtyllat e rëndësishme për menaxhimin e kapaciteteve. E rëndësishme është që i gjithë personeli që ka akses në asetet e informacionit të Bashkisë Shkodër të jetë i vetëdijshëm për rregullat dhe standardet e sigurisë dhe të jenë të aftë t'i zbatojnë dhe ndjekin ato gjatë punës së tyre.

-Me qëllim që të sigurohet parashikimi, programimi dhe implementimi i suksesshëm i veprimtarive trajnuese është e nevojshme që procesi të mbështetet në një identifikim dhe analizë të nevojave për trajnim të stafit.

Për periudhën objekt auditimi u konstatua se Bashkia Shkodër, nuk ka plan trajnimi vjetor për vitet 2019-2020 për burimet njerëzore të sektorit të Teknologjisë e Informacionit. Nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre. Trajnimet e përfituara nga ASPA apo zhvilluesit e sistemeve janë të pa mjaftueshme e nuk plotësojnë nevojat për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacioni për stafin IT.

b. Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve në TIK dhe në ofrimin e shërbimit:

Menaxhimi i riskut IT është aplikimi i metodave të menaxhimit të rrezikut në teknologjinë e informacionit për të menaxhuar rrezikun e TI-së, pra: Rreziku i biznesit që lidhet me përdorimin, pronësinë, operimin, përfshirjen, ndikimin dhe adoptimin e IT në Bashkinë Shkodër.

Nga administrimi i dokumentacionit se si Bashkia Shkodër, identifikon dhe menaxhon risqet në teknologjinë e informacionit, u konstatua se Bashkia disponon një regjistër risku të përgjithshëm për të gjithë institucionin, ku përfshihen edhe disa risqe mbi IT por nuk mbulohen të gjithë aktivitetet duke përfshirë këtu risqet mbi sistemin e tarifave dhe taksave, proceset e menaxhimit të ndryshimit, etj.

Për periudhën nën auditim konstatohet se nuk është bërë përditësim i risqeve mbi TIK, në mospërputhje me: nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Udhëzimin nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”, UMF nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

➤ **Ofrimi i Shërbimit**

Për periudhën e audituar, ofrimi i suportit teknik dhe mbështetjes logjike për operacionet IT që ndihmojnë në mbarëvajtjen e strukturave të institucionit kryhet nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve. Nisur sa më sipër, institucioni nuk ka hartuar politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT.

Duke mos realizuar identifikimin e risqeve, bashkia rrezikon që ngjarjet të përsëriten dhe mënyra e zgjidhjes së tyre është e papërcaktuar duke rrezikuar mbarëvajtjen e punës së sistemeve, ndërprerjen e shërbimeve etj. Identifikimi i risqeve çon në gjetjen e zgjidhjeve për t'i trajtuar ato dhe për të parandaluar ndodhjen e incidenteve të ngjashme në të ardhmen dhe në mënyrë që funksionet e institucionit të jenë të mbrojtura.

Pasja e procedurave të dokumentuara për zbulimin dhe regjistrimin e kushteve të parregullta ul risqet:

- e aksesit të paautorizuar të përdoruesve edhe ndërhyrjet e paautorizuara;
- e dështimeve të rrjetit;

- e funksionalitetit të ulët të programeve (ofrimi i shërbimeve);
- e mungesës së aftësive të përdoruesve final.

Mungesa e masave dhe mungesa e rregullores për trajtimin e incidenteve bën që institucioni të mos menaxhojë risqet me efekt negativ në IT dhe në proceset e punës si dhe sjell mos dokumentim dhe mos lënie gjurmësh për trajtimin e gabimeve ose incidenteve nga punonjësit e IT.

➤ *Mbi auditin e brendshëm*

Njësia e auditimit të brendshëm është e organizuar në nivel sektori e përbërë nga një përgjegjës dhe dy auditues.

Misioni i njësisë së auditimit të brendshëm, si pjesë e strukturës bashkisë Shkodër është orientimi i veprimtarisë, në mënyrë të pavarur dhe profesionale, duke dhënë garanci të arsyeshme, për eficientë, efektivitetin, ekonomikitetin e menaxhimit të burimeve, përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut. Ndjekjen e praktikave më të mira bashkëkohore dhe forcimin e kapaciteteve profesionale të auditimit.

Nga auditimi u konstatua se Njësia e Auditimit të Brendshëm në bashkinë Shkodër për vitet 2019-2020 nuk ka kryer asnjë auditim mbi sistemet e teknologjisë së informacionit, në kundërshtim me nenet 14 dhe 8 të Ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”. “Të kryejë auditime IT sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 6 dhe nenit 9 dhe në përputhje me Standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm, Veprimtaria e auditimit të brendshëm në sektorin publik duhet të kryhet në përputhje me:

- standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, të pranuar për t'u zbatuar në Republikën e Shqipërisë dhe të miratuara me urdhër të Ministrit të Financave;
- këtë ligj dhe të gjitha aktet nënligjore bazuar në këtë ligj;
- Kartën e Auditimit, Kodin e Etikës për audituesit e brendshëm, manualin e auditimit të brendshëm, si dhe akte të tjera specifike për kryerjen e shërbimit të auditimit.
- Të kryejë auditime IT sipas përcaktimeve të nenit 4. Pika 6, nenit 9 dhe në përputhje me Standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm.

Mbështetur në rregulloren e brendshme, “Për miratimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Shkodër” në nenin 33, detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë së auditimit.

Gjithashtu mbështetur në rregulloren e brendshme, “Për miratimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Shkodër” në nenin 35 “Detyrat dhe përgjegjësitë e përgjegjësit të sektorit të administrimit të sistemeve dhe menaxhimit të zyrës së integruar me një ndalesë”, pika (35.15) citohen disa nga detyrat e përgjegjësit si:

- auditimin periodik të komponenteve të sistemeve;
- kryen auditime të sigurisë për të monitoruar përputhshmërinë me standardet e Institucionit.

Njësia e auditimit të brendshëm në Bashkinë Shkodër:

- në strukturën e saj nuk ka auditues me profil teknologji informacioni;
- ka akses por nuk shfrytëzon për auditim informacion nga sistemet informatike të bashkisë;
- nuk vlerëson nëse qeverisja e teknologjisë së informacionit në bashki mbështet strategjitë dhe objektivat institucionale.

Në këtë mënyrë, nuk ka një strukturë kontrolli të mirëfilltë për auditimin e teknologjisë së informacionit në bashkinë Shkodër, duke rritur riskun e mos identifikimit të parregullsive që mund të ndodhin në sisteme. Përfshirja e auditimit të teknologjisë së informacionit në Njësinë e Auditimit të Brendshëm do të siguronte nivel më të lartë të integritetit të të dhënave që sistemet përmbajnë, duke evidentuar dobësitë e deri tek parregullsitë që mund të ndikojnë në vendimmarrje.

Si përfundim rezulton se, teknologjia e informacionit në Bashkinë Shkodër ka nevojë për përmirësime lidhur me procedura të hartuara dhe të zbatuara, për të siguruar një mirëfungsionim të proceseve të veprimtarisë së institucionit të cilat varen në mënyrë kritike nga mirë funksionimi i sistemeve të informacionit.

1. Titulli i gjetjes: Verifikimi i strategjisë institucionale dhe lidhja me objektivat e veprimtarisë së institucionit.

Situata: Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Shkodër për vitet 2015-2030 nuk përcakton politika shteruese për veprimtarinë mbi Teknologjinë e Informacionit. Kjo strategji është hartuar si një strategji ndërsektoriale gjithëpërfshirëse e Bashkisë në nivel makro. Ky dokument strategjik nuk është update-uar me ndryshimet që ka pësuar Bashkia për një periudhë 6 vjeçare në lidhje me teknologjinë e informacionit.

Nga auditimi mbi masat e marra për plotësimin objektivave të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë 2015-2030 u konstatua se nuk ka indikatorë të matshëm për plotësimin e këtyre objektivave dhe nuk flitet për element konkret dhe mënyrën se si do të arrihet përbushja e këtyre objektivave

Gjithashtu, duke patur parasysh që Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë është hartuar për një periudhë 15 vjeçare do të ishte e nevojshme hartimi i një plan-veprimi për strategjinë si dhe përcaktimin e indikatorëve të matjes së performancës së strategjisë.

Kriteri: Standardet ndërkombëtare të TI dhe praktikrat më të mira

Ndikimi/Efekt: Zhvillimi pa strategji çon në mospërdorim me 3E të burimeve.

Shkaku: Mos zbatimi Standardet ndërkombëtare të TI dhe praktikrat më të mira

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi:

Bashkia Shkodër duke patur parasysh ndryshimet strukturore dhe infrastrukturore të ndodhura në institucion të marrë masa për përditësimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë për vitet 2015-2030 me element të teknologjisë së Informacionit dhe të bëjë rishikimin e këtij dokumenti strategjik çdo 5 vjet.

Gjithashtu strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme të marrin masa për përcaktimin e elementëve dhe indikatorëve të matshëm për matjen e plotësimit të objektivave të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë.

2. Titulli i gjetjes: Mungesë e planifikimit strategjik mbi teknologjinë e informacionit.

Situata: Nga auditimi u konstatua se bashkia Shkodër nuk ka strategji për teknologjinë e informacionit, mungesa e të cilës sjell mos planifikim dhe mos pasqyrim të qartë të objektivave lidhur me infrastrukturën IT dhe sigurinë institucionale si dhe burimet e nevojshme për matjen e objektivave. Mungesa e planit strategjik, mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së bashkisë.

Kriteri: Standardet ndërkombëtare të TI dhe praktikrat më të mira

Ndikimi/efekt: Keq adresim i burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së bashkisë.

Shkaku: Mos zbatim i praktikave më të mira të fushës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni posedon dhe përpunon, të marrin masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit.

3. Titulli i gjetjes: Mos përditësimi i rregullores së brendshme administrative

Situata: Nga auditimi u konstatua se, Rregullorja e Brendshme, “Për miratimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Shkodër” miratuar me vendimin nr. 96, datë 20.03.2017 të Kryetarit të Bashkisë nuk është përshtatur (*amenduar*) duke mos reflektuar ndryshimet institucionale të ndodhura ndër vite në Bashkinë Shkodër. Në rregullore përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë duke ju referuar sektorit të administrimit të sistemeve dhe menaxhimit të zyrës së integruar me një ndalesë, por nuk përmenden fare Përgjegjësit, specialistët për sistemet e tjera si “Sistemi i Taksave dhe Tarifave Vendore; Sistemi i Shërbimit Social; Transparenca e Buxhetit”. Të gjithë këto sisteme nuk janë të reflektuar në Rregulloren e Brendshme duke mos përcaktuar elementë përkatës për të siguruar funksionim të përshtatshëm të strukturës IT në institucion.

Kriteri: Neni 64, pika “j” e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe neni 20 i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Ndikimi/efekti: Mos adresim i përgjegjësive si pasojë e keq adresimit të përcaktimit të detyrave, kompetencave dhe përgjegjësive.

Shkaku: Mos menaxhimi i ndryshimit në bazën ligjore, nënligjore dhe aktet rregullative

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

Bashkia Shkodër dhe strukturat këshilluese mbi IT, të hartojë, amendojë dhe miratojë, rregulloren e brendshme, “Për miratimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Shkodër” duke reflektuar ndryshimet institucionale, strukturore dhe kompjuterike të ndodhura ndër vite në bashki. Hartimi i kësaj Rregulloreje të marrë në konsideratë vendosjen e kontrolleve të brendshme lidhur me menaxhimin e riskut, përputhshmërinë me procedurat dhe rregullat e brendshme aktuale si dhe me legjislacionin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Shqipëri.

4. Titulli i gjetjes: Identifikimi dhe vlerësimi i problematikave mbi burimet njerëzore të strukturës TIK.

Situata: Nga auditimi u konstatua se:

-Struktura e burimeve njerëzore në Sektori i Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të ZIN, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit është e paplotësuar sipas strukturës organike të përcaktuar.

-Për periudhën objekt auditimi u konstatua se Bashkia Shkodër, nuk ka plan trajnimi vjetor për vitet 2019-2020 për burimet njerëzore të sektorit të Teknologjisë e Informacionit. Nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre. Trajnimet e përfituara nga ASPA apo zhvilluesit e sistemeve janë të pa mjaftueshme e nuk plotësojnë nevojat për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacioni për stafin IT.

-Për punonjësit e sektorit të Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të ZIN, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit nuk janë hartuar dhe miratuar përshkrimet e punës si dhe kriteret për kualifikimet e punonjësve për këtë sektor.

Kriteri: Standardet ndërkombëtare të TIK për rritjen e kapaciteteve dhe ligji për Nëpunësin Civil.

Ndikimi/efekti: Mungesa e aftësive për zbatimin e rregullave dhe standardeve të sigurisë së informacionit gjatë përdorimit të aseteve.

Shkaku: Mungesë planifikimi.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrin masa për menaxhimin e burimeve njerëzore, gjithashtu të marrin masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit IT dhe të çdo përdoruesi të sistemeve TIK si dhe të hartojë e miratojë plane dhe politika për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

5. Titulli i gjetjes: Hierarkia dhe organizimi i strukturës TIK

Situata: Nga auditimi u konstatua se funksionimi dhe organizimi i strukturës së IT-së në nivel sektori nën Drejtorinë e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse, nuk i përgjigjet shtrirjes së teknologjisë së informacionit në bashki dhe njësisë të vartësisë duke sjellë uljen e ndikimit të IT-së në qeverisjen e bashkisë si dhe zbeh ndikimin e varësisë direkt nga menaxhimi i lartë.

Kriteri: Standardet ndërkombëtare të TIK në organizimin funksional të strukturave.

Ndikimi/efekti: Mos pasqyrimin e qartë të objektivave të bashkisë lidhur zhvillimet teknologjike dhe zbehje e ndikimit të strukturave TIK në vendimmarrje.

Shkaku: Paqartësi mbi rëndësinë e strukturave TIK dhe mos zbatim i praktikave më të mira të fushës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme të analizojnë mundësinë e ndryshimeve strukturore të strukturës ekzistuese IT me qëllim rritjen e rolit të saj dhe të marrin masa për ngritjen në nivel të strukturës së IT nga nivel sektori në nivel Drejtorie.

6. Titulli i gjetjes: Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve në TIK

Situata: Nga administrimi i dokumentacionit për identifikimin dhe menaxhimin e riskut në teknologjinë e informacionit, konstatohet se Bashkia disponon një regjistër risku të përgjithshëm për të gjithë institucionin, ku përfshihen edhe disa risqe mbi IT por nuk mbulohen të gjithë aktivitetet duke përfshirë këtu risqet mbi sistemin e tarifave dhe taksave, proceset e menaxhimit të ndryshimit, etj. Për periudhën nën auditim konstatohet se nuk është bërë përditësim i risqeve mbi TIK, në mospërputhje me: nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Udhëzimin nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”, UMF nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

Kriteri: Nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Udhëzimin nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”, UMF nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

Ndikimi/efekti: Mos identifikimi i ndikimit të risqeve çënon ecurinë normale të punës së sistemeve, ndërprerjen e shërbimeve etj, si dhe rrezikon që mënyra dhe koha e zgjidhjes së problemeve të jetë e papërcaktuar.

Shkaku: Mos marrja e masave për identifikimin dhe dokumentimin e risqeve mbi TI.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

Bashkia Shkodër në bashkëpunim me strukturat këshilluese mbi TIK dhe sektorin TIK, të marrin masat e nevojshme për përditësimin dhe dokumentimin e regjistrit të risqeve dhe të marrin masa për hartimin dhe dokumentimin e një plani veprimi për minimizimin/parandalimin e risqeve të identifikuara, si dhe të bëhet monitorimi periodik i zbatimit të këtyre masave.

7. Titulli i gjetjes: Mos menaxhim i incidenteve, dhe mungesa e plan veprimit për minimizimin e risqeve.

Situata: Për periudhën e audituar, u konstatua se bashkia Shkodër nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e

gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT, dhe në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh. Suporti, mbështetje teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit, kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve.

Ndikimi/efekti: Mos realizim i objektivave, shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave.

Shkaku: Mos zbatim i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Shkodër në bashkëpunim me sektorin TIK të marrin masa për identifikimin, dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve si dhe menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre.

8.Titulli i gjetjes: Bashkia Shkodër nuk ka zhvilluar auditime IT dhe nuk ka zhvilluar burimet njerëzore të Auditit të brendshëm me njohuri të mjaftueshme mbi *teknologjinë e informacionit*.

Situata: Njësia e Auditimit të Brendshëm në bashkinë Shkodër për vitet 2019-2020 nuk ka kryer asnjë auditim mbi sistemet e teknologjisë së informacionit, në kundërshtim me nenet 14 dhe 8 të Ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”. “Të kryejë auditime IT sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 6 dhe nenit 9 dhe në përputhje me Standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm.

Njësia e auditimit të brendshëm në Bashkinë Shkodër:

- në strukturën e saj nuk ka auditues me profil teknologji informacioni;
- ka akses por nuk shfrytëzon për auditim informacion nga sistemet informatike të bashkisë;
- nuk vlerëson nëse qeverisja e teknologjisë së informacionit në bashki mbështet strategjitë dhe objektivat institucionale.

Në këtë mënyrë, nuk ka një strukturë kontrolli të mirëfilltë për auditimin e teknologjisë së informacionit në bashkinë Shkodër, duke rritur riskun e mos identifikimit të parregullsive që mund të ndodhin në sisteme.

Kriteri: Ligji nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”. Standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm *Veprimtaria e auditimit të brendshëm në sektorin publik duhet të kryhet në përputhje me:*

a) *standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, të pranuar për t'u zbatuar në Republikën e Shqipërisë dhe të miratuara me urdhër të Ministrit të Financave;*

b) *këtë ligj dhe të gjitha aktet nënligjore bazuar në këtë ligj;*

c) *Kartën e Auditimit, Kodin e Etikës për audituesit e brendshëm, manualin e auditimit të brendshëm, si dhe akte të tjera specifike për kryerjen e shërbimit të auditimit*

Të kryejë auditime IT sipas përcaktimeve të nenit 4. Pika 6, nenit 9 dhe në përputhje me Standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm.

Ndikimi/efekti: Risk në mos identifikimit të parregullsive që mund të ndodhin në sisteme.

Shkaku: Mos zbatim nga menaxhmenti i përcaktimeve ligjore

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Bashkia Shkodër të marrin masa për zhvillimin e burimeve njerëzore të Auditit të brendshëm me njohuri të mjaftueshme mbi teknologjinë e informacionit dhe mbulimin me auditim të brendshëm IT të sistemeve IT, sektorit IT pranë bashkisë si dhe përdoruesit e sistemeve informatike në përputhje me përcaktimet ligjore.

Për sa është konstatuar më lart, mbi auditimin e funksionimit të qeverisjes TIK, mbajnë përgjegjësi znj. V.A në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë sipas detyrave funksionale të përcaktuara në zbatim të neneve 3, 4, 7, 59 dhe nenit 64 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe z. R.S, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë, z. P.Z, në cilësinë

e Përgjegjësit të Njësisë së Auditit dhe znj. A.P në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse sipas detyrave funksionale të përcaktuara në zbatim të neneve 65 dhe 66 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, si dhe detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme, “Për miratimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Shkodër” miratuar me vendimin nr. 96, datë 20.03.2017 të Kryetarit të Bashkisë.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 1, datë 16.07.2021, protokolluar në Bashkinë Shkodër me nr. 7670/3 datë 16.07.2021 si dhe është trajtuar në faqet 7-18 të Projektraportit të Auditimit, mbi të cilin nuk janë paraqitur observacione.

III.2.2. Auditimi i Sigurisë së Informacionit:

Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij.

Siguria e informacionit është bërë gjithnjë e më shumë e rëndësishme për institucionet, kjo vjen si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkë përdorimi i burimeve të informacionit. Siguria e Informacionit mund të përcaktohet si metoda e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me kushtet e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë.

Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion publik shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: “*Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TI, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i asetëve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TI*”.

a. Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike dhe aksesit në rrjet

Verifikimi i shkallës së sigurisë së dhomës së serverëve me qëllim, parandalimin e vjedhjes ose të dëmtimit të pajisjeve kompjuterike, aksesit të paautorizuar, kopjimit ose shikimit të informacionit sensitiv.

➤ *Ambienti fizik i dhomave të serverave*

Auditimit mbi shkallën e sigurisë së dhomës së serverave, u krye në bazë të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*” dhe Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (*versioni 1.0, datë 02.12.2008*) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK për administratën publike.

Duke qenë se dhoma e serverëve është pika më delikate e një sistemi informatik dhe përqendrimi i pajisjeve kompjuterike, mekanike, elektrike dhe elektronike është më i lartë se në ambientet e tjera të punës. Dëmet eventuale të shkaktuara në këtë ambient do të sillnin probleme serioze në funksionimin e të gjithë sistemit.

Për këtë qëllim, grupi i auditimit, të shoqëruar nga personat përgjegjës të sektorit të Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të ZIN, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit në Bashkinë Shkodër, zhvilloi verifikimin e dhomës së serverave të lokalizuar në katin e parë të Bashkisë.

Nga auditimi u konstatua se:

Ambienti fizik i dhomës së serverave nuk është në përputhje me standardet e përcaktuara në Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (*Versioni 1.0, datë 02.12.2008*) miratuar nga AKSHI (*Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit*), përkatësisht:

Ruajtja e pajisjeve fizike, kontrolli i aksesit fizike mbi pajisjet, kontrolli mbi personat që kanë akses fizik:

- ambienti ku janë lokalizuar serverat e bashkisë dhe network-u, nga karakteristika ka qenë një zyrë ekzistuese e cila është përshtatur për tu përdorur si dhomë serverësh.
- pajisjet elektronike si serverat dhe pajisjet e rrjetit janë të ruajtura në këtë hapësirë, ku kanë akses vetëm specialistet e TI, ky ambient është i mbyllur me derë të blinduar i lokalizuar në katin e parë të godinës së Bashkisë;
- nuk ka pajisje të sigurisë fizike të aksesit dhe sistem *intrusion detection* për të kufizuar personat e paautorizuar.
- aksesit në ambientin e dhomës së serverëve nuk është i kontrolluar me teknologji të tilla si: skanime, lexues karte, etj.
- bëhet regjistrimi me video (*kamera sigurie*) për monitorimin e portave hyrëse për në dhomën e serverave dhe në pjesë të tjera të perimetrit të ndërtesës.
- Parandalimi i zjarrit: dhoma duhet të jetë e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit; dhoma duhet të jetë rezistente ndaj zjarrit nëse kabllot dhe sistemet e ftohjes kombinohen në të njëjtën hapësirë sipër tavanit ose nën dysheme.
- Sistemi Elektrik. Instalimi elektrik i dhomës së serverëve nuk është veçmas instalimit të përgjithshëm.
- Sistemi i Alarmit. Mungon sistemi i alarmit. Duhet të jenë të tillë që të sinjalizojnë problemet me rrymën elektrike, me ambientin fizik, sensor për rrjedhjen e ujit, sensor për parandalimin e dëmtimeve fizike të strukturës së dhomës.

Pozicionimi i rakeve të serverëve dhe pajisjeve të networkut është organizuar në një dhomë serverësh.

Figura nr.2: Pamjet e mëposhtme tregojnë gjendjen e dhomës së serverëve dhe asetëve të ndodhura në të (Paraqiten dy Rack me struktura fizike metalike dhe pjesët përbërëse të sistemit të pajisjeve elektronike dhe elektrike: server, switch, router, UPS, panele etj).





Burimi: Grupi i Auditimit

➤ **Auditimi mbi pajisjet Firewall, Internet dhe Lan të Bashkisë Shkodër si dhe në Njësitë Administrative.**

Referuar pikave kryesore të sigurisë së informacionit në rrjetin privat dhe publik janë verifikuar konfigurimet e sigurisë mbi switch-et dhe firewall-in e institucionit, nga auditimi rezultoi se rrjeti i bashkisë nuk është i ndarë në rrjet privat dhe në rrjet publik (internet).

Komunikimi me njësitë administrative, realizohet me fibër optike dhe si shtesë sigurie përdoret një VPN IPSEC e cila përdor parametra enkriptimi çka e bën komunikimin e sigurtë.

Nga auditimi mbi konfigurimet aktuale për switch-et kryesore u konstatua se:

- Nuk janë marrë masat e nevojshme që useri admin² të limitohet në logimin vetëm nga IP-të brenda rrjetit privat dhe nuk është e bllokuar që useri admin të logohet nga jashtë rrjetit, pra nga një rrjet publik.
- Nuk janë krijuar zona me limite të caktuara për brenda LAN si dhe rrjeti nuk është i ndarë në VLAN (rrjete virtuale) çka do të bënte të mundur menaxhimin dhe lejimin e grupeve të IP-ve në shërbime të ndryshme sipas nevojave. Gjithashtu nuk është krijuar edhe një zonë Untrust e cila sipas konfigurimeve shërben për bllokimin e portave të shërbimeve si dhe bllokimin e IP-ve të cilat mund të paraqesin problematika ose sulme.
- Pajisjet switch aksesohen në çdo moment në qoftë se je lidhur në rrjetin e bashkisë dhe aksesimi i tyre realizohet me të njëjtat kredenciale të njëjlojta. Kjo gjë do të rrit mundësinë për sulme nga skripte/viruse.
- Koha e vendosur tek të gjitha switchet është manuale duke mos treguar kohën dhe datën reale të ndodhjes së një problematike, duke ndikuar në të dhënat e logeve, pasi çdo log dhe gjurmë e dokumentuar nuk ka të dhëna të sakta se çfarë date/ore ka ndodhur.

Bashkia Shkodër për rritjen e sigurisë së qasjes në rrjet dhe ruajtjen nga sulmet e mundshme, ka investuar së fundmi për blerjen e pajisjes firewall të markës Cisco Firepower 1120 Threat Defense.


-Pajisja firewall ka të aktivizuar log çka bën të mundur për të verifikuar një sërë procesesh që routeri kryen si edhe ruajtjen e tyre.

-Back-up i pajisjes kryhet në mënyrë manuale.

-Nuk janë krijuar group users me nivele të ndara menaxhim/monitorim. Çdo veprim bëhet nga useri admin.

² i emërtuar "Cisco"

Figura nr.3: Në foton e mëposhtme ilustrohet ndërfaqja e firewall



Burimi: Grupi i Auditimit.

➤ **Portali³ web i Bashkisë Shkodër**



Portali i Bashkisë Shkodër është hostuar në serverin me karakteristikat e mëposhtme:

| | |
|--------------------------|--|
| Marka e serverit | <i>Dell</i> |
| Modeli i serverit | <i>Power Edge 2850</i> |
| HDD | <i>146.5 GB x 3</i> |
| RAID | <i>5</i> |
| RAM | <i>4 GB</i> |
| CPU | <i>Intel(R) Xeon(TM) CPU 3.20GHz 2 CPU fizik</i> |

³ <http://www.bashkiashkoder.gov.al/>

Foto ilustruese e modelit të serverit




Procedura e backup mbi portalin web realizohet si më poshtë:

- Backup-i i tre ditëve të fundit mbahet në server;
- Një herë në 7 ditë kopjohet kopja e fundit e backup-it në serverin e backup-eve;
- Një herë në muaj shkruhet në media portabël dhe ruhet në kasafortë.

Testimi i Webpage të Bashkisë Shkodër për dobësi:

Për testimin e performancës së faqes së internetit u bënë disa pen-test⁴ për sjelljen e faqes web sipas browserit të zgjedhur, si dhe disa teste të thyerjes së sigurisë dhe mangësive. Kjo metodë përdoret për gjetjen e gabimeve siç është “404’s” ose probleme më komplekse siç janë burimet e jashtme që bllokojnë pasqyrimin e faqes (*page rendering*).

Nga auditimi dhe mbikëqyrja e faqes Web u konstatua se:



Portali nuk përdor një lidhje të sigurtë (*connection security*) HTTPS (*HyperText Transfer Protocol Secure*) (Not secure status) pra komunikimi ndërmjet web browser-it dhe serverit kryhet duke përdorur protokollin HTTP, që do të thotë se serveri i faqes së internetit nuk përdor një certifikatë sigurie për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletues. Në mungesë të kësaj certifikate mund të ndodhë humbja e privatësisë, ndryshimit të informacionit që merret ose jepet me anë të këtij portali. Gjithashtu një sulmues i jashtëm, i cili arrin të hyj në rrjeti, ka mundësi të lexojë dhe ndryshojë informacionin i cili aksesoret nga rrjeti, duke përfshirë (fjalëkalimet-et, të dhëna sekret si dhe të tjera të dhëna sensitive). Nëse ndodh një sulm, tipit të software-ve dhe versioni i përdorur identifikohen lehtësisht dhe mund të përdoren për sulme specifike. Mbrojtësi X-XSS i HTTP dikton shfletuesin (browserin) të mos hap faqe webi të cilat kapin sulme Cross-Site Scripting (XSS) të reflektuar. Për shkak të këtij mbrojtësi, web siti ekspozohen përdoruesit tek sulmuesit e XSS, nëse faqja web i ka këto dobësi.

Në kuadrin e transparencës Bashkia Shkodër ka afishuar në faqen e saj web, organigramën e institucionit, ku përfshihen, strukturat e të gjithë administratës dhe njësisive administrative, statutin, kodin e etikës, rregulloren e brendshme, etj. Faqja web:

- nuk ka të afishuar numrat e kontaktit dhe orarin e ofrimit të shërbimeve ndaj publikut;
- tek menuja “shërbime dhe kontakte” ka të afishuar linkun e bashkisë që të dërgon te adresa faqes zyrtare të bashkisë në rrjetin social facebook.
- Nuk administrohet rregullore për faqen e Web;
- nuk realizohet monitorimi i statistikave të vizitorëve të faqes web (*p.sh.me google analytics*).
- faqja web vetëm në version shqip kufizon përdoruesit e kësaj faqeje dhe promovimin e shërbimeve dhe aseteve të kësaj bashkie.

Figura nr.4: Më poshtë paraqitet printscreen i mangësive, i marrë nga raporti i testimit me pen test

⁴ teste të thyerjes së sigurisë dhe mangësive

Summary

Overall risk level:

High

Risk ratings:



Scan information:

Start time: 2021-08-21 12:08:00 UTC+03
Finish time: 2021-08-21 12:08:58 UTC+03
Scan duration: 58 sec
Tests performed: 17/17
Scan status: **Finished**

Burimi: Grupi i auditimit.

Në total janë zbuluar përkatësisht 17 dobësi të faqes së webit, në 4 nivele të ndryshme të riskut:




- 1 prej tyre është e nivelit të lartë të riskut. mod_session_dbd.c në mod_session_dbd moduli në Apache HTTP Server i konsideron veprimet operationale të sigurta pa marrë parasysh risqet e njoftuara dhe kërkesat për një përcaktim të ri të identifikimit, e cila ka një impakt favorizues kundrejt sulmuesve në distancë.
- 3 kanë riskun në nivel mesatar. Konfigurimi jo i duhur i Proxy bën që trajtimi i të dhënave mos të jetë i duhuri duke mos transmetuar në mënyrën e duhur të dhënat duke tejkuluar vlerën e Content-length, gjë e cila lejon sulmuesit në distancë të shkaktojnë një refuzim të shërbimit (konsumi i CPU) përmes kërkesave të hartuara.
- Në nivelin e ulët u gjendën 6 gjetje risku. Algoritmi i “OpenSSL DSA” është vulnerabël nga sulmet e mundshme të kanalizuar në kohë. Një sulmues mund të përdorë variacione të ndryshme në algoritmin e logimit duke gjeneruar passwordin sekret. Duke qenë se faqja web është e përbërë nga 1.0.2n ky version është i vjetërsuar. Kjo problematikë rregullohet duke bërë update me versionet e reja OpenSSL 1.1.1a.
- Gjithashtu janë 6 risqe informacioni.

Këto dobësi i ekspozojnë aplikacionet e prekura ndaj rrezikut të qasjes së paautorizuar në të dhënat konfidenciale dhe rrit mundësinë e sulmeve (*denial of service*).

b. Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit

Bashkia Shkodër disponon aktualisht 4 server të cilët plotësojnë nevojat për web, aplikacionin software si dhe shërbimet e ofruara nëpërmjet web-service, në funksion të pagesave të tatim-taksave dhe shërbimeve me një ndalesë në bashkinë Shkodër.

Figura nr.5: Më poshtë paraqiten disa karakteristika teknike rreth pajisjeve hardware



Burimi: Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit.

➤ *Procedura e backup*

Qëllimi i procedurës së kryerjes së backup-it të sistemeve në përdorim është që të sigurojë metoda dhe procedura të standardizuara mbi këto procese, duke siguruar kështu ruajtjen e të dhënave të serverave dhe mundësimin e rikthimit të këtyre të dhënave në raste të defekteve kritike ose rasteve të tjera të humbjes së të dhënave.

Procedura e hartuar/e ndjekur nuk është e pasqyruar apo e dokumentuar në ndonjë dokument administrativ si Rregullore e Brendshme apo dokument tjetër TIK ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup-ve, procesin e ruajtjes së të dhënave për sistemet në përdorim nga punonjësit e Bashkisë Shkodër.

Backup-i i serverit, në të cilën ndodhet databaza e sistemit S1NJD dhe sistemit të taksave dhe tarifave vendore të bashkisë, konfigurohet automatikisht. Backup i të dhënave realizohet në mënyrë automatike dhe është i skedualuar në SQL server agent. Realizimi i backup është llogaritur të kryhet çdo ditë në fund të ditës. Nuk përdoret enkriptim për transferimin e backup-it.

Ruajtja e backupit bëhet në serverin lokal, në storage-in e rrjetit të lidhur në serverin lokal të lokalizuar në dhomën e serverëve si dhe në google drive, memorie që është në pronësi të një operatori privat që ofron shërbime në bashki.

Nga auditimi u konstatua se:

- Procedurat e rikthimit (restore) të të dhënave nuk testohen për t'u siguruar që ato janë të efektshme dhe që ato mund të ekzekutohen brenda kohës së lejuar për sistemet e sipërpërmendura.
- ruajtja e backup në vende jashtë godinës së bashkisë, në distancë nuk realizohet;
- nuk realizohet backup për loget e sistemit të hyrje-daljeve të personelit;
- pajisjet e rrjetit (*switch dhe router*), konfigurimet e tyre nuk janë bërë backup;
- nuk është e qartë nëse kontrollohet statusi i backup-it nëse procedura është kryer me sukses;
- ruajtja e backup në google drive që nuk është në pronësi të bashkisë rrit çënueshmërinë e të dhënave dhe sigurinë e tyre. Në rast të përfundimit të kontratës së mirëmbajtjes me operatorin që ofron shërbimin, nuk është e përcaktuar se ku do të ruhet backup pas kësaj dhe si do ti kalojë backup-i më i vjetër që ndodhet tashmë në drive-in e operatorit.

➤ *Active Directory*

Pa Active Directory, çdo kompjuter në rrjet ka bazën e të dhënave të veta të vogla të emrave të përdoruesve dhe fjalëkalimeve. Microsoft e quan këtë lloj krijimi një GRUP PUNE (WORKGROUP), domethënë çdo kompjuter vepron më vete dhe nuk ka kontroll qendror. Ky lloj konfigurimi krijon një sfidë kur kemi shumë kompjutera dhe një përdorues duhet të ketë qasje në njërin prej tyre ose kur ai ndryshon fjalëkalimin ose emrin e përdoruesit. Active Directory mban në një memorie të centralizuar, emrat, përdoruesit dhe fjalëkalimet. Çdo ndryshim në emrat e përdoruesit dhe fjalëkalimet regjistrohen nga Active Directory dhe të gjithë kompjuterët në rrjet kanë qasje në këtë informacion. Prandaj Active Directory:

- Është në thelb një bazë të dhënash;
- siguron kontroll të centralizuar;
- regjistron të gjitha ndryshimet e fjalëkalimeve;
- mund të shpërndahet në të gjithë botën;
- ruan burimet si Printerët dhe share folders
- shërbimet si Email mund të përdorin Active Directory

Administratorët e rrjetit e përdorin Active Directory për të ruajtur dhe organizuar objekte në një rrjet (të tilla si përdoruesit, kompjuterët, pajisjet, etj.) Në një strukturë të sigurt hierarkike të kontrollit që njihet si strukturë logjike.

Nga administrimi i dokumentacionit mbi parametrat e pajisjeve Server u konstatua se Bashkia Shkodër për menaxhimin e userave, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qendëruar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet ka ngritur Active Directory.

Nga auditimi u konstatua se Bashkia Shkodër nuk përdor të gjitha përfitimet e Active Directory për:

- Përfitimin e një performance më të mirë të aplikacionit;
- Garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve të ofruara;
- Krijim dhe logimin e përdoruesve të administratës së bashkisë dhe marrjen e shërbimeve me anë të një autentifikimi të vetëm “*single sign in*”. Përdoruesit mund të logohen me adresën e emailit në pc, në email, në rrjet e etj me anë të domain controller-it duke patur një autentifikim të sigurt. Me anë të “*single sign in*” përdoruesit mund të logojnë:
 - në PC;
 - në network (wifi me pajisjet, laptop, smartphone, tablet, etj);
 - në email;
 - në apps;
 - etj.

Duke krijuar usera manualisht, konfigurimin e emaileve për çdo user në mënyrë manuale dhe ruajtjen e të dhënave të përdoruesve në pc e tyre pa kontroll të qendëruar rrezikon kompromentimin e sigurisë së infrastrukturës network në bashkinë Shkodër.

Nga auditimi i rrjetit kompjuterik që lidh Bashkinë Shkodër me njësitë administrative rezultoi se:

- Përdoruesit në këto njësi janë lidhur me fibër optike dhe marrin shërbimin në një Switch;
- Konfigurimet në rrjet të PC janë si administratorë;
- Në të njëjtin switch marrin shërbime disa njësi.

➤ ***Mbi verifikimin e dokumentimit të planeve për vazhdueshmërinë e biznesit dhe rimëkëmbjes nga katastrofat***

Auditimi mbi planin e vazhdueshmërisë së biznesit u bazua mbi VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit*”, risqeve të identifikuar dhe praktikave më të mira. Referuar kësaj VKM-je, çdo institucion që ka ose do të zhvillojë sisteme në fushën e teknologjisë së informacionit, me qëllim ofrimin e shërbimeve tek qytetarët, për biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbim informacioni për administratën publike nëpërmjet këtyre sistemeve, duhet të parashikojë dhe të marrë masat e nevojshme për krijimin e sistemit të vazhdueshmërisë së punës dhe sistemit të ruajtjes së informacionit, me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimit pa ndërprerje dhe parandalimin e humbjes ose shkatërrimit të të dhënave. Në kundërshtim me këtë VKM, Bashkia Shkodër, si institucion që posedon disa sisteme informacioni, që ruajnë, përpunojnë dhe gjenerojnë të dhëna me rëndësi për realizimin e skemës së tatim taksave vendore të bashkisë si dhe ofrimin e shërbimeve me një ndalesë kundrejt qytetarëve.

Nga auditimi u konstatua se bashkia Shkodër, nuk rezulton të ketë, dokumentim/ implementim të politikave/planeve mbi sigurinë e informacionit. Bashkia Shkodër nuk disponon dokumentacione në lidhje me:

- Planet e vazhdueshmërisë së punës (BCP), në rastet e dështimit të dhomës së serverave që suportojnë sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore sistemin e Zyrës me Një Ndalesë, sistemin e Shërbimit Social dhe transparenca e Buxhetit. Këto dokumente përcaktojnë masat, procedurat dhe objektivat të mirë dokumentuara për rivendosjen në funksionim të sistemit në rastet e emergjencave dhe që sigurojnë vazhdueshmërinë e punës së sistemeve si

dhe përcaktimin e RTO (Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes) dhe RPOs (Objektivat e Punës së Ripërtëritjes) për çdo proces kritik.

1. Titulli i gjetjes: Dhoma e serverave nuk plotëson standardet e përcaktuara.

Situata: Nga auditimi u konstatua se ambienti fizik i dhomës së serverëve në bashkinë Shkodër nuk është në përputhje me standardet e përcaktuara në rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve të miratuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Kriteri: Rregullorja për ndërtimin e dhomës së serverëve (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI.

Ndikimi/efekti: Cënimi i sigurisë, hyrje e paautorizuara dhe risk humbje të të dhënave

Shkaku: Mos njohje e bazës rregullatore mbi standardet dhe sigurinë fizike të ambienteve të infrastrukturave kritike.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

Bashkia Shkodër të marrë masa për ndërtimin e ambienteve të dhomës të serverave në bazë të rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK si dhe në përputhje me udhëzimet, standardet dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

2. Titulli i gjetjes: Problematika mbi sigurinë e aksesit dhe infrastrukturën network

Situata: Referuar pikave kryesore të sigurisë së informacionit në rrjetin privat dhe publik janë verifikuar konfigurimet e sigurisë mbi switch-et dhe firewall-in e institucionit, dhe nga verifikimi rezultoi se:

-Rrjeti i bashkisë nuk është i ndarë në rrjet privat dhe në rrjet publik (internet);

-Për konfigurimet aktuale për switch-et kryesore, nuk janë marrë masat e nevojshme që useri admin të limitohet në logimin vetëm nga IP-të brenda rrjetit privat dhe nuk është e bllokuar që useri admin të logohet nga jashtë rrjetit, pra nga një rrjet publik;

-Nuk janë krijuar zona me limite të caktuara për brenda LAN si dhe rrjeti nuk është i ndarë në VLAN (rrjete virtuale) çka do të bënte të mundur menaxhimin dhe lejimin e grupeve të IP-ve në shërbime të ndryshme sipas nevojave. Gjithashtu nuk është krijuar edhe një zonë Untrust e cila sipas konfigurimeve shërben për bllokimin e portave të shërbimeve si dhe bllokimin e IP-ve të cilat mund të paraqesin problematika ose sulme;

-Pajisjet switch aksesohen në çdo moment në qoftë se je lidhur në rrjetin e bashkisë dhe aksesimi i tyre realizohet me të njëjtat kredenciale të njëllajta. Kjo gjë do të rrit mundësinë për sulme nga skripet/viruse;

-Koha e vendosur tek të gjitha switchet është manuale duke mos treguar kohën dhe datën reale të ndodhjes së një problematike, duke ndikuar në të dhënat e logeve, pasi çdo log dhe gjurmë e dokumentuar nuk ka të dhëna të sakta se çfarë date/ore ka ndodhur;

-Për administrimin e firewall nuk janë krijuar group users me nivele të ndara menaxhim/monitorim. Çdo veprim bëhet nga useri admin.

Kriteri: Ligji nr. 2/2017 ‘‘Për Sigurinë Kibernetike’’; ISO/IEC 27001.

Ndikimi/efekti: Aksesimi i paautorizuar dhe thyerje e mundshme e sigurisë së infrastrukturës network

Shkaku: Implementimi i konfigurimeve jo të përshtatshme të sigurisë

Rëndësia: e Lartë

Rekomandimi: Sektori TIK pranë bashkisë Shkodër të marrë masat e nevojshme për krijimin e konfigurimeve përkatëse në rrjetin e institucionit mbi logimin, konfigurimin dhe sigurinë e switch-ve dhe firewall-it. Të krijohen zona me limite të caktuara brenda LAN si dhe rrjeti të konfigurimet në VLAN (rrjete virtuale) për menaxhimin dhe lejimin e grupeve të IP-ve në shërbime të ndryshme sipas nevojave. Gjithashtu të merren masa për administrimin dhe

implementimin e të gjitha konfigurimeve të nevojshme të evidentuara nga auditimi dhe të tjera të mundshme, me qëllim rritjen e sigurisë së infrastrukturës network.

3. Titulli i gjetjes: Mungesa e elementeve të sigurisë përgjatë navigimit

Situata: Nga auditimi dhe mbikëqyrja e faqes web u konstatua se:

Portali nuk përdor një lidhje të sigurtë (*connection security*) HTTPS (*HyperText Transfer Protocol Secure*) (*Not secure status*) pra komunikimi ndërmjet web browser-it dhe serverit kryhet duke përdorur protokollin HTTP, që do të thotë se serveri i faqes së internetit nuk përdor një certifikatë sigurie për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletues.

Situata: Në kuadrin e transparencës bashkia Shkodër ka afishuar në faqen e saj web, organigramën e institucionit, ku përfshihen, strukturat e të gjithë administratës dhe njësie administrative, statutin, kodin e etikës, rregulloren e brendshme, etj. Faqja web:

-nuk ka të afishuar numrat e kontaktit dhe orarin e ofrimit të shërbimeve ndaj publikut;

-tek menuja “shërbime dhe kontakte” ka të afishuar linkun e bashkisë që të dërgon te adresa faqes zyrtare të bashkisë në rrjetin social facebook.

-nuk administrohet rregullore për faqen e web;

-nuk realizohet monitorimi i statistikave të vizitorëve të faqes web (*p.sh.me google analytics*).

-faqja web vetëm në version shqip kufizon përdoruesit e kësaj faqeje dhe promovimin e shërbimeve dhe aseteve të kësaj bashkie.

Kriteri: Objektivi 4.2. Promovimi i Produkteve Turistike gjithëvjetore brenda dhe jashtë vendit, i Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të turizmit 2019 – 2023

Situata: Në total janë zbuluar përkatësisht 17 dobësi të faqes së webit, në 4 nivele të ndryshme të riskut. Këto dobësi i ekspozojnë aplikacionet e prekura ndaj rrezikut të qasjes së paautorizuar në të dhënat konfidenciale dhe rrit mundësinë e sulmeve (*denial of service*).

Ndikimi/efekti: Humbja e privatësisë, ndryshimit të informacionit që merret ose jepet me anë të portalit.

Shkaku: Mos zbatim i standardeve më të mira të fushës.

Rekomandimi:

Bashkia Shkodër në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për mbarëvajtjen e faqes web, të marrin masa për përmirësimin e faqes web me elementët përkatës të sigurisë (*certifikatën e sigurisë*) së navigimit online për të rritur sigurinë si dhe të merren masa për përmirësimin dhe përditësimin e faqes web me (informacione, ligje, rregullore, akte, etj) për të rritur ndihmesën ndaj qytetarëve. Të reflektohen dobësitë e dala nga auditimi dhe të kihet parasysh që në të ardhmen të shtohen elementë inovativ në faqen web për ta bërë atë sa më interaktive dhe ndihmëse për qytetarët.

4. Titulli i gjetjes: Planet e vazhdimësisë së punës dhe procedurat e backup.

Situata: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Shkodër, nuk rezulton të ketë, dokumentim/ implementim të politikave/planeve mbi sigurinë e informacionit. Bashkia Shkodër nuk disponon dokumentacione në lidhje me:

- Planet e vazhdueshmërisë së punës (BCP), në rastet e dështimit të dhomës së serverave që suportojnë sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore sistemin e Zyrës me Një Ndalesë, sistemin e Shërbimit Social dhe transparenca e Buxhetit.

- Procedurat e rikthimit (restore) të të dhënave nuk testohen për t'u siguruar që ato janë të efektshme dhe që ato mund të ekzekutohen brenda kohës së lejuar për sistemet e sipërpërmendura.

- ruajtja e backup në vende jashtë godinës së bashkisë, në distancë nuk realizohet;

- nuk realizohet backup për loget e sistemit të hyrje-daljeve të personelit;

- pajisjet e rrjetit (*switch dhe router*), konfigurimet e tyre nuk janë bërë backup;

- nuk është e qartë nëse kontrollohet statusi i backup-it nëse procedura është kryer me sukses;

- ruajtja e backup në google drive që nuk është në pronësi të bashkisë rrit cënueshmërinë e të dhënave dhe sigurinë e tyre. Në rast të përfundimit të kontratës së mirëmbajtjes me operatorin që ofron shërbimin, nuk është e përcaktuar se ku do të ruhet backup pas kësaj dhe si do ti kalojë backupi më i vjetër që ndodhet tashmë në drive-in e operatorit.

Kriteri: Standardet nga Autoriteti Kombëtar Për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare (*COBIT dhe Manuali i Auditimit IT*).

Ndikimi/efekti: Humbje e të dhënave dhe risk për vazhdimësinë e punës dhe ndërprerjes së shërbimeve.

Shkaku: Mos zbatim i standardeve të sigurisë mbi ruajtjen dhe përpunimin e informacionit

Rëndësia: E lartë

Rekomandim:

Strukturat drejtuese në bashkinë Shkodër në bashkëpunim me sektorin e IT-së të marrin masa për ndërtimin dhe hartimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat.

Gjithashtu të merren masat e nevojshme që ruajtja e të dhënave dhe backup-eve të sistemeve të realizohet në memorie dhe hapësira virtuale që janë në pronësi të bashkisë me qëllim garantimin e sigurisë së informacionit dhe cënimin e të dhënave të sistemeve.

1. Konkluzion:

Nga administrimi i dokumentacionit mbi parametrat e pajisjeve server u konstatua se bashkia Shkodër për menaxhimin e userave, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qendëruar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet ka ngritur Active Directory..

Në opinionin e grupit të auditimit bashkia Shkodër nuk përdor të gjitha përfitimet e Active Directory në mënyrë që të:

-Përfitojë një performancë më të mirë të aplikacionit;

-Garantojë vazhdimësinë e shërbimeve të ofruara;

-Krijim dhe logimin e përdoruesve të administratës së bashkisë dhe marrjen e shërbimeve me anë të një autentifikimi të vetëm “*single sign in*”. Përdoruesit mund të logohen me adresën e emailit në pc, në email, në rrjet e etj me anë të domain controller-it duke patur një autentifikim të sigurt. Me anë të “*single sign in*” përdoruesit mund të logojnë, në PC; në network (wifi me pajisjet, laptop, smartphone, tablet, etj); në email; në apps; etj.

Për sa është konstatuar më lart, mbi auditimin e sigurisë së informacionit, mbajnë përgjegjësi znj. V.A në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë sipas detyrave funksionale të përcaktuara në zbatim të neneve 3, 4, 7, 59 dhe nenit 64 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe znj. A.P në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, dhe z. J.H, z. P.M, znj. S.D në cilësinë e specialistit të sektorit të administrimit të sistemeve, menaxhimit të ZIN, projekteve TIK dhe menaxhimit të sistemeve të informacionit, sipas detyrave funksionale të përcaktuara në zbatim të neneve 65 dhe 66 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme, “Për miratimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Shkodër” miratuar me vendimin nr. 96, datë 20.03.2017 të Kryetarit të Bashkisë.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 2, datë 16.07.2021, protokolluar në Bashkinë Shkodër me nr. 7670/4 datë 16.07.2021 si dhe është trajtuar në faqet 18-29 të Projektraportit të Auditimit mbi të cilin janë paraqitur observacione mbi Aktkonstatimin, me shkresën nr. 7670/8, datë 23.07.2021, protokolluar në KLSH me nr. 552/2, datë 28.07.2021.

1. Pretendimi i subjektit:


Bashkia Shkodër nuk disponon një numër kontakti, prandaj në faqen web të saj nuk shfaqet një informacion i tillë.

Versioni në anglisht i faqes ekziston por nevojitet përditësim dhe plotësim i vazhdueshëm me informacion, por përgatitja e materialit për publikim nuk është në kompetencat e sektorit TIK.

1.1. Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

1. Mos disponimi i një numër kontakti nuk është argument për të kundërshtuar konstatimin e grupit të auditimit. Fakti është, që grupi i auditimit e ka konstatuar këtë gjë, gjatë fazës së auditimit në terren.

2. Në lidhje me pretendimin tuaj që versioni i faqes ekziston por nevojitet përditësim, ju informojmë që gjatë fazës së auditimit në terren grupi i auditimit e verifikoi këtë konstatim në prani të specialistit të sektorit të IT. Faqja web e bashkisë ka të afishuar mundësinë për të zgjedhur gjuhën në anglisht por çdo informacion i populluar aty është në gjuhën shqipe, pra nuk ka asgjë në gjuhën angleze. Më poshtë po ju bashkëlidhim një printscreen të faqes web mbi këtë çështje.



Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi me vëmendje këtë observacion konkludoi si më poshtë:

Nga bashkia Shkodër janë paraqitur argumente shpjeguese pa fakte të reja për pasojë konstatimi i grupit të auditimit nuk ndryshon. Konstatimi i grupit të auditimit lidhet me nevojën për përmirësim që ka kjo problematikë, pa anashkaluar punën e bërë deri në këtë kohë nga ana e bashkisë, për pasojë konstatimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

2. Pretendimi i subjektit:

Realizimi i testeve të ndryshme të faqes web për identifikimin e mangësive dhe dobësive është një proces i vlefshëm në rritjen e cilësisë dhe sigurisë së një faqeje, në të cilën Bashkia Shkodër e sheh si një sugjerim të vlefshëm për ta aplikuar si mënyrë sistematike në vazhdim.

Përsa i përket burimit të parashtruar nga ju, evidentohet që janë gjeneruar 17 dobësi të faqes web të Bashkisë Shkodër, ndër të cilat dhe 7 rrisq informacioni.

Nga realizimi i pen-test të gjeneruar nga ana jonë, duke përdorur pen-testtools.com, 7 sinjalizimet e informacionit, ne i konsiderojmë si informacione mbi faqen web dhe jo si dobësi, si psh: Website is accessible, e cila është thjeshtë një informacion dhe jo një risk informacioni.

2.1. Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Në shtjellimin e kësaj çështje të trajtuar në aktkonstatim, grupi i auditimit i ka cilësuar risqe informacioni sikurse edhe ju pretendoni më lart.

Nisur sa më sipër, Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi me vëmendje këtë observacion konkludoi si më poshtë:

Nga bashkia Shkodër janë paraqitur argumente shpjeguese pa fakte të reja për pasojë konstatimi i grupit të auditimit nuk ndryshon. Konstatimi i grupit të auditimit lidhet me nevojën për përmirësim që ka kjo problematikë, për pasojë konstatimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

3. Pretendimi i subjektit:

Me qëllim garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve të ofruara në Bashkinë Shkodër, Active Directory është i vendosur në 2 servera të lidhur në mirror me njëri tjetrin.

3.1. Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi me vëmendje këtë observacion konkludoi si më poshtë:

Nga bashkia Shkodër janë paraqitur argumente shpjeguese pa fakte të reja për pasojë konstatimi i grupit të auditimit nuk ndryshon. Konstatimi i grupit të auditimit lidhet me nevojën për përmirësim që ka kjo problematikë, për pasojë konstatimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

III.2.3. Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit:

➤ Procedurat e Prokurimit:

Bashkia Shkodër, bazuar në Regjistrin e Realizimeve, vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe verifikimit në Sistemin e Prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, për gjatë vitit 2019 ka realizuar 8 procedura prokurimi me bazë Teknologjinë e Informacionit dhe gjatë vitit 2020 ka realizuar 4 procedura prokurimi me bazë Teknologjinë e Informacionit si më poshtë:

| Nr. | Objekti i Prokurimit Viti 2019 | Fondi Limit | Lloji i Procedurës së Prokurimit | Vlera e kontratës | Data e zhvillimit te procedurës së prokurimit | Operatori Ekonomik i shpallur fitues | Data e lidhjes se kontratës | Data e përfundimit kontratës |
|-----|---|-------------|----------------------------------|-------------------|---|--------------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| 1 | Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) | 2,500,000 | Kërkesë për propozim | 2,019,000 | 11/11/2019 10:00 AM | P.S | 1/16/2020 | 2/16/2020 |
| 2 | Furnizim vendosje kamera sigurie për ambiente publike | 5,552,500 | Kërkesë për propozim | 5,511,266 | 09/09/2019 11:00 AM | R | 12/2/2019 | 1/2/2020 |
| 3 | Mirëmbajtje e faqes zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj | 250,000 | Blerje me vlerë të vogël | 242,000 | 28/03/2019 01:00 PM | A.I | 09/04/2019 | 31/12/2019 |
| 4 | Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Bashkisë Shkodër | 2,168,333 | Kërkesë për propozim | 2,107,917 | 26/04/2019 12:00 PM | E.XH | 7/17/2019 | 12/31/2019 |
| 5 | Mirëmbajtje pajisje Informatike | 500,000 | Blerje me vlerë të vogël | 455,500 | 18/11/2019 03:00 PM | B.O | 30/12/2019 | 29/01/2020 |

| | | | | | | | | |
|--------------|--|-------------------|----------------------|-------------------|------------------------|---|-----------|-----------|
| 6 | Shërbim GPS+Monitorim | 510,000 | Kërkesë për propozim | 510,000 | 03/05/2019 12:00 PM | A | 8/13/2019 | 8/20/2020 |
| 7 | Shërbim Interneti | 1,750,000 | Kërkesë për propozim | 980,000 | 07/10/2019 12:00 PM | I | 1/10/2020 | 1/10/2021 |
| 8 | Sistemi i Vëzhgimit i 15 Njësi Administrative me Bashkinë Qendër | 2,500,000 | Kërkesë për propozim | 1,960,000 | 15/02/2019 10:00 AM | R | 5/7/2019 | 6/7/2019 |
| TOTAL | | 15,730,833 | | 13,785,683 | | | | |

| Nr. | Objekti i Prokurimit Viti 2020 | Fondi Limit | Lloji i Procedurës së Prokurimit | Vlera e kontratës | Operatori Ekonomik i shpallur fitues | Data e lidhjes se kontratës | Data e përfundimit kontratës |
|--------------|---|-------------------|----------------------------------|-------------------|--------------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| 1 | Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) | 3,087,498 | Kërkesë për propozim | 3,026,155 | B.E | 10/7/2020 | 11/22/2020 |
| 2 | Mirëmbajtje e faqes zyrtare web www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj | 750,000 | Kërkesë për propozim | 747,000 | A.I | 11/19/2020 | 11/18/2022 |
| 3 | Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Informacionit të Bashkisë Shkodër | 7,144,989 | Kërkesë për propozim | 7,131,000 | E.XH | 7/1/2020 | 12/31/2020 |
| 4 | Mirëmbajtje pajisje informatike | 265,000 | Blerje me vlerë të vogël | 251,400 | B.O | 11/12/2020 | 10/01/2020 |
| TOTAL | | 11,247,487 | | | | | |

➤ Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit (MNSH)

Bashkia Shkodër, bazuar në Regjistrin e Realizimeve vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe verifikimit në Sistemin e Prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, për gjatë vitit 2019 ka realizuar 4 procedura prokurimi me bazë Marrëveshjen në Nivel Shërbimi (MNSH) si dhe gjatë vitit 2020 ka realizuar 2 procedura prokurimi me bazë Marrëveshjen në Nivel Shërbimi (MNSH) si më poshtë:

| Nr. | Objekti i Prokurimit Viti 2019 | Fondi Limit | Lloji i Procedurës së Prokurimit | Vlera e kontratës | Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit | Operatori Ekonomik i shpallur fitues | Data e lidhjes se kontratës | Data e përfundimit kontratës |
|--------------|---|-------------------|----------------------------------|-------------------|---|--------------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| 1 | Mirëmbajtje e faqes zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj | 250,000 | Blerje me vlerë të vogël | 242,000 | 28/03/2019 01:00 PM | A.I | 09/04/2019 | 31/12/2019 |
| 2 | Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Bashkisë Shkodër | 2,168,333 | Kërkesë për propozim | 2,107,917 | 26/04/2019 12:00 PM | E.XH | 7/17/2019 | 12/31/2019 |
| 3 | Shërbim GPS+Monitorim | 510,000 | Blerje me vlerë të vogël | 510,000 | 03/05/2019 12:00 PM | A | 8/13/2019 | 8/20/2020 |
| 4 | Shërbim Interneti | 1,750,000 | Kërkesë për propozim | 980,000 | 07/10/2019 12:00 PM | I | 1/10/2020 | 1/10/2021 |
| TOTAL | | 15,730,833 | | 13,785,683 | | | | |

| Nr. | Objekti i Prokurimit Viti 2020 | Fondi Limit | Lloji i Procedurës së Prokurimit | Vlera e kontratës | Operatori Ekonomik i shpallur fitues | Data e lidhjes se kontratës | Data e përfundimit kontratës |
|-----|--------------------------------|-------------|----------------------------------|-------------------|--------------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|-----|--------------------------------|-------------|----------------------------------|-------------------|--------------------------------------|-----------------------------|------------------------------|

| | | | | | | | |
|---|--|-------------------|----------------------|-----------|------|------------|------------|
| 1 | Mirëmbajtje e faqes zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj | 750,000 | Kërkesë për propozim | 747,000 | A.I | 11/19/2020 | 11/18/2022 |
| 2 | Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Informacionit të Bashkisë Shkodër | 7,144,989 | Kërkesë për propozim | 7,131,000 | E.XH | 7/1/2020 | 12/31/2020 |
| | TOTAL | 11,247,487 | | | | | |

1.Titulli i gjetjes: Asnjë nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nuk janë specialist të fushës së Teknologjisë së Informacionit.

Situata: Nga auditimi i procedurave të prokurimeve për blerjet me vlerë të vogël, u konstatua se, në dy procedura prokurimi, në përbërje të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nuk janë përfshirë specialist të fushës së Teknologjisë së Informacionit. Konkretisht:

a) “Mirëmbajtje e faqes zyrtare web www.bashkiashkodër.gov.al dhe moduleve të integruara të saj” Viti 2019, procedurë prokurimi “Blerje me Vlerë të Vogël, me fond limit 250,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E “AI” me ofertë 242,000 lekë pa TVSH në përbërjen e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, asnjë nga anëtarët e komisionit nuk janë specialist të fushës së Teknologjisë së Informacionit. Konkretisht:

GJ.H (Jurist)

D.K (Inxh. Ndërtimit)

E.H (Ekonomist)

b) “Mirëmbajtje pajisje informatike” Viti 2019, procedurë prokurimi “Blerje me Vlerë të Vogël, me fond limit 498,898 lekë pa TVSH, me fitues O.E “B.O.O” me ofertë 455,500 lekë pa TVSH në përbërjen e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, asnjë nga anëtarët e komisionit nuk janë specialist të fushës së Teknologjisë së Informacionit. Konkretisht:

E.D (Jurist)

D.K (Inxh. Ndërtim)

E.H (Ekonomist)

Ndikimi/Efekti: Vlerësim në mënyrë jo të duhur të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Shkaku: Mosnjohja me ligjin përkatës dhe neglizhenca e krijuar nga personat përgjegjës

Kriteri: Neni 58 i VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me Vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me Vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 me Vendimin nr. 797, datë 29.12.2017 dhe me Vendimin nr. 80 datë 14.2.2018.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Titullari i Institucionit dhe personat autorizues mbi hartimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, në procedurat e ardhshme, gjatë krijimi të Njësive të Prokurimit dhe të Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave, të bazohen në kornizat ligjore dhe rregullative dhe të përfshijnë minimumi një specialist të fushës përkatëse të procedurës së prokurimit.

2.Titulli i gjetjes: Ndryshim në përmbajtjen e dokumentacionit të ofertës së dërguar nga Operatori Ekonomik.

Situata: Nga auditimi u konstatua se për procedurën e prokurimit “Mirëmbajtje Pajisje Informatike” viti 2020, procedurë prokurimi “Blerje me Vlerë të Vogël”, me fond limit 264,961 lekë pa TVSH, me fitues O.E “B.O.O” me ofertë 251,400 lekë pa TVSH, pas verifikimit të dokumentacionit dërguar nga O.E. “B.O.O”, data e lëshimit të vërtetimit të shlyerjes së taksave dhe tarifave vendore mban datën 04.12.2020 nr.376 Prot., ndërkohë që afati i dërgimit të ofertave ka qenë data 25.11.2020 ora 12:00, me përgjegjës Komisionin e Vlerësimit të Ofertave me përbërje:

E.D (Kryetar)

D.K (Anëtar)

E.H (Anëtar).

Ndikimi/Efekti: Vlerësim dhe klasifikim i gabuar i O.E pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Shkaku: Mos kryerja e detyrave funksionale sipas përcaktimeve të ligjeve përkatëse.

Kriteri: Nenin 63 i VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me Vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me Vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 me Vendimin nr. 797, datë 29.12.2017 dhe me Vendimin nr. 80 datë 14.2.2018.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të kenë parasysh që gjatë vlerësimit të O.E pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, të bazohen në legjislacionin përkatës që të mos lejojnë asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në dokumentacion apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

3.Titulli i gjetjes: Asnjë nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nuk janë specialist të fushës së Teknologjisë së Informacionit.

Situata: Nga auditimi u konstatua se procedurën e prokurimit “Shërbim GPS + Monitorim” viti 2019, procedurë prokurimi “Kërkesë për Propozim” me fond limit 510,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E “A” shpk me ofertë 510,000 lekë pa TVSH, pas verifikimit të dokumentacionit të procedurës së prokurimit rezultoi që në Njësinë e Prokurimit dhe në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave asnjë nga anëtarët nuk është specialist i fushës. Konkretisht:

Komisioni i prokurimit

- E.D (Jurist)
- D.K (Inxh. ndërtimi)
- M.B (Ekonomist)

dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave

- A.L (Jurist)
- B.D (Ekonomist)
- H.M (Inxh. Mekanik)

me përgjegjës titullarin i institucionit znj. V..A, në cilësinë e hartueses së urdhrat për ngritjen e KVO-së dhe z. E.D në cilësinë e Përgjegjës të Prokurimit.

Ndikimi/Efekti: Vlerësim në mënyrë jo të duhur të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Shkaku: Mosnjohja me ligjin përkatës dhe neglizhenca e krijuar nga personat përgjegjës.

Kriteri: Nenin 57 & 58 i VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me Vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me Vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 me Vendimin nr. 797, datë 29.12.2017 dhe me Vendimin nr. 80 datë 14.2.2018.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Titullari i Institucionit dhe personat autorizues mbi hartimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, në procedurat e ardhshme të prokurimit, gjatë krijimi të Njësave të Prokurimit dhe të Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave, të bazohen në kornizat ligjore dhe rregullative dhe të përfshijnë minimumi një specialist të fushës përkatëse të procedurës së prokurimit.

4.Titulli i gjetjes: Në kontratat e shërbimeve në fushën e Teknologjisë së Informacionit mungon Marrëveshja e Nivelit të Shërbimit.

Situata: Për procedurat e prokurimeve :

- “Mirëmbajtje e faqes zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj” viti 2019, procedurë prokurimi “Blerje me Vlerë të Vogël” me fond limit 250,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E “ A.I” me ofertë 242,000 lekë pa TVSH.

- *“Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Bashkisë Shkodër” viti 2019*, procedurë prokurimi “Kërkesë për Propozim” me fond limit 2,168,333 lekë pa TVSH, me fitues O.E “E.XH” me ofertë 2,107,917 lekë pa TVSH.
- *“Shërbim GPS+Monitorim” viti 2019*, procedurë prokurimi “Blerje me Vlerë të Vogël” me fond limit 510,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E “A-T-D” me ofertë 510,000 lekë pa TVSH.
- *“Shërbim Interneti” viti 2019*, procedurë prokurimi “Kërkesë për Propozim” me fond limit 1,750,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E “I” me ofertë 980,000 lekë pa TVSH.
- *“Mirëmbajtje e faqes zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj”, viti 2020*, procedurë prokurimi “Kërkesë për Propozim” me fond limit 750,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E “A.I” me ofertë 747,000 lekë pa TVSH.
- *“Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Bashkisë Shkodër” viti 2020*, procedurë prokurimi “Kërkesë për Propozim” me fond limit 7,144,989 lekë pa TVSH, me fitues O.E “E.XH” me ofertë 7,131,000 lekë pa TVSH.

Nga auditimi u konstatua se kontratat e mësipërme nuk janë hartuar sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 710, datë 21.08.2013 *“Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”* i ndryshuar pika 2 si dhe sipas Udhëzimit nr. 1159 datë 17.3.2014 *“Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit”*, në të cilën cilësohet që kontratatave të llojeve të mësipërme duhet t’ju bashkëngjitet Aneksi nr.1 i MNSH (Marrëveshjes të Nivelit të Shërbimit), me përgjegjës z. E.D në cilësinë e Përgjegjës të Prokurimeve dhe znj. A.D në cilësinë titullarit të Institucionit.

Ndikimi/Efekti: Mundësia e ofrimit të shërbimit me ndërprerje dhe humbja ose shkatërrimi aksidental i të dhënave.

Shkaku: Mos kryerja e detyrave funksionale konform me ligjet dhe udhëzimet përkatëse.

Kriteri: VKM nr. 710, date 21.08.2013 *“Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”* i ndryshuar pika 2 si dhe Udhëzimi nr. 1159 datë 17.3.2014 *“Për Hartimin E Marrëveshjes Së Nivelit Të Shërbimit”*

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Titullari i Institucionit dhe personat autorizues mbi hartimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, në procedurat e prokurimit, me bazë shërbimet në Teknologjinë e Informacionit të kenë parasysh që në hartimin e kontratave të shërbimit të bazohen në legjislacionin e sipërpërmendur duke hartuar Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit.

5.Titulli i gjetjes: Mungesa e vazhdimësisë së shërbimeve si shkak i vonesave të lidhjes së kontratave.

Situata: Nga auditimi u konstatua se, në dy raste, procedurat e prokurimit dhe kontratat e zbatimit janë realizuar me shumë vonesë, duke lenë pa mbuluar me shërbimin përkatës periudha kohore nga përfundimi i afatit të kontratës së mëparshme deri në lidhjen e kontratave të reja. Konkretisht:

- *“Mirëmbajtje e faqes zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj” viti 2019*, procedurë prokurimi “Blerje me Vlerë të Vogël” me fond limit 250,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E “A.I” me ofertë 242,000 lekë pa TVSH.

data e lidhjes së kontratës është 09.04.2019 nr.4824/6, ndërkohë që afati i kontratës së mëparshme për të njëjtin shërbim ka përfunduar më datë 31.12.2018 dhe diapazoni kohor midis 01.01.2019-09.04.2019 mbetet pa shërbim.

- *“Mirëmbajtje e faqes zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj” viti 2020*, procedurë prokurimi “Kërkesë për Propozim” me fond limit 750,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E “A.I” me ofertë 747,000 lekë pa TVSH, data e lidhjes së kontratës është 19.11.2020, ndërkohë që afati i kontratës së mëparshme për të njëjtin shërbim ka përfunduar më datë 31.12.2019 dhe diapazoni kohor midis 01.01.2020-19.11.2020 mbetet pa shërbim, me përgjegjës z. E.D në cilësinë e Përgjegjës të Prokurimeve.

Ndikimi/Efekti: Mundësia që institucioni të mbetet pa shërbim ose mundësia e ofrimit të shërbimit me ndërprerje.

Shkaku: Mosnjohja me udhëzimin përkatës dhe neglizhenca e krijuar nga personat përgjegjës

Kriteri: Pika 4 e Udhëzimit nr.1159 datë 17.3.2014 “Për Hartimin E Marrëveshjes Së Nivelit Të Shërbimit”

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Personat autorizues mbi hartimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, në procedurat e prokurimit, me bazë shërbimet në Teknologjinë e Informacionit, në sistemet ekzistuese, të parashikojnë MNSH-në, kohëzgjatja e së cilës duhet të jetë jo më e shkurtër se 2 (dy) vjet.

6.Titulli i gjetjes: Në mbarëvajtjen e shërbimeve me bazë Teknologjinë e Informacionit mungojnë raportet mbi cilësinë dhe vazhdueshmërinë e shërbimeve.

Situata: Nga auditimi u konstatua se, gjatë zbatimit të 6 kontratave nuk është kryer matja e cilësisë së shërbimit dhe mungojnë raportet e shërbimit dhe të vlerësimeve mbi performancën e shërbimit. Konkretisht kjo shkelje është konstatuar në këto kontrata:

- “Mirëmbajtje e faqes zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj” viti 2019, procedurë prokurimi “Blerje me Vlerë të Vogël” me fond limit 250,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E “A.I” me ofertë 242,000 lekë pa TVSH.
- “Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Bashkisë Shkodër” viti 2019, procedurë prokurimi “Kërkesë për Propozim” me fond limit 2,168,333 lekë pa TVSH, me fitues O.E “E.Xh” me ofertë 2,107,917 lekë pa TVSH.
- “Shërbim GPS+Monitorim” viti 2019, procedurë prokurimi “Blerje me Vlerë të Vogël” me fond limit 510,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E “A” me ofertë 510,000 lekë pa TVSH.
- “Shërbim Interneti” viti 2019, procedurë prokurimi “Kërkesë për Propozim” me fond limit 1,750,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E “It” me ofertë 980,000 lekë pa TVSH.
- “Mirëmbajtje e faqes zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj”, viti 2020, procedurë prokurimi “Kërkesë për Propozim” me fond limit 750,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E “A.I” me ofertë 747,000 lekë pa TVSH.
- “Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Bashkisë Shkodër” viti 2020, procedurë prokurimi “Kërkesë për Propozim” me fond limit 7,144,989 lekë pa TVSH, me fitues O.E “E.Xh” me ofertë 7,131,000 lekë pa TVSH.

nuk është kryer matja e cilësisë së shërbimit dhe mungojnë raportet e shërbimit dhe të vlerësimeve mbi performancën e shërbimit me përgjegjës z. J.H, H.S, M.B në cilësinë e personave përgjegjës për ekzekutimin e kontratës.

Ndikimi/Efekti: Mundësia që cilësia e shërbimit të jetë jo në gjendjen optimale si dhe mundësia e ndodhive të incidenteve dhe moszgjidhja në kohë reale e tyre të jetë e lartë.

Shkaku: Mosnjohja me udhëzimin përkatës dhe neglizhenca e krijuar nga personat përgjegjës

Kriteri: Pika 8 ç dhe dh e Udhëzimit nr.1159 datë 17.3.2014 “Për Hartimin E Marrëveshjes Së Nivelit Të Shërbimit”

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Personat autorizues mbi ndjekjen e zbatimit të kontratës të kryejnë matjen e cilësisë së shërbimeve dhe të kryejnë raporte periodike mbi ecurinë e shërbimit bazuar në kontratën e lidhur midis O.E dhe A.K.

Për sa është konstatuar më lart, mbi auditimin e zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit, mbajnë përgjegjësi znj. V.A në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë sipas detyrave funksionale të përcaktuara në zbatim të neneve 3, 4, 7, 59 dhe nenit 64 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe z. E.D në cilësinë e përgjegjësit të prokurimeve, z. J.H, z. P.M, znj. S.D, znj. D.K, z. E.H, znj. H.S dhe z. M.B, në cilësinë e specialistit të prokurimeve

sipas detyrave funksionale të përcaktuara në zbatim të neneve 57 dhe 58 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, me Vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me Vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 me Vendimin nr. 797, datë 29.12.2017 dhe me Vendimin nr. 80 datë 14.2.2018 si dhe në zbatim të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 3 dhe 4, datë 16.07.2021, protokolluar në Bashkinë Shkodër me nr. 7670/5 dhe 7670/6 datë 16.07.2021 si dhe është trajtuar në faqet 30-35 të Projektraportit të Auditimit mbi të cilin janë paraqitur observacione mbi Aktkonstatimin nr. 4, me shkresën nr. 7670/9, datë 23.07.2021, protokolluar në KLSH me nr. 552/2, datë 28.07.2021.

Në lidhje me Gjetjen nr.4

1. Pretendimi i subjektit:

Duke e konsideruar si një rekomandim të drejtë për tu shtuar në kontratat aktuale dhe/apo të ardhshme të investimeve dhe shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit, Aneksi I Për Elementet e Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit (Mnsh), duhet theksuar se mungesa vjen si rezultat se Udhëzimi Nr.1159 datë 17/03/2014 "Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit Të Shërbimit, në pikën 7 të tij ngarkon të gjitha institucionet e qeverisjes qendrore për zbatimin e tij, duke mos specifikuar domosdoshmërisht institucionet e qeverisjes vendore, ndër të cilat bën pjesë bashkia e Shkodrës.

1.1. Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Udhëzimi Nr.1159 datë 17/03/2014 "Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit Të Shërbimit, është në zbatim të pikës 2 të Vendimit nr. 710, datë 21.8.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit" dhe në pikën 7 të udhëzimit në fjalë citohet:

"Ngarkohen të gjitha institucionet e qeverisjes qendrore, sipas përcaktimit të pikës 1, për zbatimin e këtij udhëzimi" ku tregohet që edhe institucionet që janë të përcaktuara në pikën 1 të Vendimit nr.710 datë 21.08.2013 të zbatojnë udhëzimin në fjalë.

Institucionet që janë të përcaktuara në pikën 1 të Vendimit nr.710 datë 21.08.2013 janë vetëm institucionet qendrore që duhet të parashikojnë dhe të realizojnë investime për krijimin e sistemit të vazhdueshmërisë së punës (Business Continuity) dhe sistemit të ruajtjes së informacionit (Backup).

Udhëzimi Nr.1159 datë 17/03/2014 "Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit Të Shërbimit dhe Vendimi nr. 710, datë 21.8.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit" citojnë që çdo institucion, i cili ka ose do të zhvillojë një sistem në fushën e teknologjisë së informacionit, që ofron shërbime për qytetarët, për biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbim informacioni për administratën publike nëpërmjet sistemeve elektronike, duhet të parashikojë dhe të hartojë marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit (Service Level Agreement - SLA).

Grupi i auditimit, nisur sa më sipër dhe pasi shqyrtoi me vëmendje këtë observacion konkludoi se konstatimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

Në lidhje me Gjetjen nr.5

2. Pretendimi i subjektit:

Marrja e angazhimit për procedurën e prokurimit "Mirëmbajtje e faqes zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj" për vitin 2019 me nr.993/b është depozituar pranë Njësisë së Prokurimit me datë 18/03/2019. Në zbatim të detyrave funksionale në cilësinë e Përgjegjësit të Prokurimeve, Z .E.D ka realizuar procedurën e prokurimit sipas afateve ligjore të përcaktuar deri në lidhjen e kontratës së shërbimit me

nr.48246 Prot e nënshkruar me datë 09/04/2019. Marrja e angazhimit për procedurën e prokurimit "Mirëmbajtje e faqes zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj" për vitin 2020 me nr.2972/b Prot është depozituar pranë Njesisë së Prokurimit me datë 23/09/2020, për arsye të pezullimeve të procedurave të prokurimeve publike për shkak të gjendjes së emergjencës në Republikën e Shqipërisë si pasojë e pandemisë COVID-19.

Për këtë arsye, në zbatim të detyrave funksionale në cilësinë e Përgjegjësit të Prokurimeve, E.D ka realizuar procedurën e prokurimit sipas afateve ligjore të përcaktuar deri në nënshkrimin e marrëveshjes kuadër 3-vjecare "Mirëmbajtje e faqes zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj" me nr.13988/l Prot me datë 19/11/2020 dhe kontratës së shërbimit nr.1 me nr. 13988/12 Prot me date 19/11/2020.

Duke e konsideruar si një rekomandim të drejtë për tu shtuar në kontratat aktuale dhe/apo të ardhshme të investimeve dhe shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit, ANEKSI I PËR ELEMENTËT E MARRËVESHJES SË NIVELIT TË SHËRBIMIT (MNSH), duhet theksuar se mungesa vjen si rezultat se Udhëzimi Nr.1159 datë 17/03/2014 "Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit Të Shërbimit, në pikën 7 të tij ngarkon të gjitha institucionet e qeverisjes qendrore për zbatimin e tij, duke mos specifikuar domosdoshmërisht institucionet e qeverisjes vendore, ndër të cilat bën pjesë bashkia e Shkodrës

2.2 Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Bazuar në Udhëzimin Nr.1159 datë 17/03/2014 "Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit Të Shërbimit" pika 4 citon: "Institucionet, të cilat kanë sisteme ekzistuese, të parashikojnë MNSH-në, kohëzgjatja e së cilës duhet të jetë jo më e shkurtër se 2 (dy) vjet" dhe nëse do ishte marrë parasysh ky udhëzim shërbimi i mirëmbajtjes së faqes zyrtare do të vazhdonte i pandërprerë dhe i mbuluar nga kontrata e nënshkruar.

Përsa i përket pikës 7 të udhëzimit nr.1159 datë 17.03.2014 "Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit Të Shërbimit" është sqaruar në Qëndrimin e Grupit të Auditimit nr. 1.1.

Grupi i auditimit, nisur sa më sipër dhe pasi shqyrtoi me vëmendje këtë observacion konkludoi se konstatimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

Në lidhje me Gjetjen nr.6

3. Pretendimi i subjektit:

Për vitin 2019

Përpilimi i kontratës "Mirëmbajtje e faqes zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj" me nr.48246 Prot e nënshkruar me datë 09/04/2019, nuk ka qenë dhe nuk është detyrë funksionale e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse apo e Sektorit TIK. Në kontratë, në Nenin 21 Administratori i Kontratës, për institucionin është përcaktuar H.S si person përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, e cila në periudhën 08/09/2018 - 16/06/2019 rezultoi me leje lindje. Megjithatë në zbatim të Nenit 21 të kësaj kontrate, H.S pas rikthimit në detyrë me date 17/06/2019, ka ndjekur zbatimin e kontratës dhe cilësinë e ofrimit të shërbimit IT, si dhe ka kryer procedurat e marrjes në dorëzim të shërbimit, duke thirrur komisionin e marrjes në dorëzim të shërbimit, në zbatim të Urdhrit të Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë nr.34 datë 21/01/2019 "Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e specifikimeve teknike, testimin të tregut, llogaritjes së fondit limit, hartimit të preventivave, marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, ndjekjes së zbatimit të kontratave për procedurat e prokurimit publik", dhe operatorin ekonomik për ofrimin e shërbimit A.I shpk, duke siguruar cilësinë e ofrimit të shërbimit në zbatim të dokumentit të specifikimeve teknike të kësaj procedure, të dokumentuar përmes dy procesverbaleve të marrjes në dorëzim, përkatësisht: Procesverbal për marrje në dorëzim Nr.13486 / 1 Prot datë 09/08/2021 dhe Procesverbal për marrje në dorëzim Nr. 22699 Prot datë 31/12/2021 (të cilët në përmbytjen e tyre kanë të dhëna të ngjashme me ato që kërkohen nga pika 8, gërma q dhe dh e udhëzimit). Mungon matja e cilësisë së shërbimit, si dhe përpilimi i raporteve të shërbimit dhe të vlerësimeve mbi

performancën e shërbimit në përputhje me Udhëzimin Nr.1159 datë 17/03/2014 "Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit Të Shërbimit" pika 8 9, dh, për sa kohë nuk ka qenë e specifikuar në asnjërin nga nenet e kontratës së shërbimit dhe në detyrimet e personit përgjegjës për ndjekjen e saj , H.S, nga Autoriteti Kontraktues. Duke e konsideruar si një rekomandim të drejtë për tu shtuar në kontratat aktuale dhe/apo të ardhshme të investimeve dhe shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit , ANEKSI I PER ELEMENTËT E MARRËVESHJES SË NIVELIT TË SHËRBIMIT (MNSH), duhet theksuar se mungesa vjen si rezultat i Udhëzimit Nr.1159 datë 17/03/2014 "Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit Të Shërbimit, në pikën 7 të tij ngarkon të gjitha institucionet e qeverisjes qendrore për zbatimin e tij, duke mos specifikuar domosdoshmërisht institucionet e qeverisjes vendore, ndër të cilat bën pjesë bashkia e Shkodrës.

Përpilimi i kontratës "Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Bashkisë Shkodër" me nr.6080/12 Prot e nënshkruar me datë 17/07/2019, nuk ka qenë dhe nuk është detyrë funksionale e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse apo e Sektorit TIK. Në kontratë, në Nenin 36 - Përfaqësimi i Palëve , për institucionin është përcaktuar znj. H.S si person përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kontratës. Në zbatim të këtij neni, znj. H.S ka mbikëqyrur zbatimin e kontratës dhe cilësinë e ofrimit të shërbimit, si dhe ka kryer procedurën e marrjes në dorëzim të shërbimit, duke thirrur komisionin e marrjes në dorëzim të shërbimit, në zbatim të Urdhrit të Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë nr.34 datë 21/01/2019 "Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e specifikimeve teknike, testimin të tregut, llogaritjes së fondit limit, hartimit të preventivave , marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, ndjekjes së zbatimit të kontratave për procedurat e prokurimit publik ", dhe operatorin ekonomi për ofrimin e shërbimit E.Xh-PF, duke siguruar cilësinë e ofrimit të shërbimit në zbatim të dokumentit të specifikimeve teknike të kësaj procedure, të dokumentuar përmes procesverbaleve I mujore të marrjes në dorëzim (të cilët në përmbajtjen e tyre kanë të dhëna të ngjashme me ato që kërkohen nga pika 8, germa 9 dhe dh e udhëzimit), deri në përfundimin e saj datë 31.12.2019. Gjithashtu është plotësuar dhe dorëzuar pranë APP edhe FORMULARI I RAPORTIMIT PËR ZBATIMIN E KONTRATËS, në përfundim të saj. Mungon matja e cilësisë së shërbimit , si dhe përpilimi i raporteve të shërbimit dhe të vlerësimeve mbi performancën e shërbimit në përputhje me Udhëzimin Nr. 1159 datë 17/03/2014 "Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit Të Shërbimit "pika 8 9, dh., për sa kohë nuk ka qenë e specifikuar në asnjërin nga nenet e kontratës së shërbimit dhe në detyrimet e personit përgjegjës për ndjekjen e saj , znj. H.S, nga Autoriteti Kontraktues. Duke e konsideruar si një rekomandim të drejtë për tu shtuar në kontratat aktuale dhe/apo të ardhshme të investimeve dhe shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit, ANEKSI I PËR ELEMENTËT E MARRËVESHJES SË NIVELIT TË SHËRBIMIT (MNSH), duhet theksuar se mungesa vjen si rezultat se Udhëzimi Nr.1159 datë 17/03/2014 "Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit Të Shërbimit, në pikën 7 të tij ngarkon të gjitha institucionet e qeverisjes qendrore për zbatimin e tij, duke mos specifikuar domosdoshmërisht institucionet e qeverisjes vendore, ndër të cilat bën pjesë bashkia e Shkodrës.

Përpilimi i kontratës "Shërbim GPS + Monitorim" me nr.6548/12 Prot e nënshkruar me datë 17/07/2019, nuk ka qenë dhe nuk është detyrë funksionale e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse apo e Sektorit TIK. Në kontratë, në Nenin 36 - Përfaqësimi i Palëve, për institucionin është përcaktuar z.M.B si person përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kontratës. Në zbatim të këtij neni, z.M.B ka mbikëqyrur zbatimin e kontratës dhe cilësinë e ofrimit të shërbimit, si dhe ka kryer procedurën e marrjes në dorëzim të shërbimit, duke thirrur komisionin e marrjes në dorëzim të shërbimit, në zbatim të Urdhrit të Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë nr.34 datë 21/01/2019 "Për ngritjen e grupit të punës

për përgatitjen e specifikimeve teknike, testimin të tregut, llogaritjes së fondit limit, hartimit të preventivave, marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, ndjekjes së zbatimit të kontratave për procedurat e prokurimit publik", dhe operatorin ekonomik për ofrimin e shërbimit A shpk, duke siguruar cilësinë e ofrimit të shërbimit në zbatim të dokumentit të specifikimeve teknike të kësaj procedure, të dokumentuar përmes procesverbaleve 1 mujore të marrjes në dorëzim (të cilët në përmbajtjen e tyre kanë të dhëna të ngjashme me ato që kërkohen nga pika 8, germa i; dhe dh e udhëzimit), deri në përfundimin e saj datë 31.12.2019. Gjithashtu është plotësuar dhe dorëzuar pranë APP edhe FORMULARI I RAPORTIMI PËR ZBATIMIN E KONTRATËS, në përfundim të saj. Mungon matja e cilësisë së shërbimit, si dhe përpilimi i raporteve të shërbimit dhe të vlerësimeve mbi performancën e shërbimit në përputhje me Udhëzimin Nr.1159 datë 17/03/2014 "Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit Të Shërbimit "pika 8 i, dh, për sa kohë nuk ka qenë e specifikuar në asnjërin nga nenet e kontratës së shërbimit dhe në detyrimet e personit përgjegjës për ndjekjen e saj, z.M.B, nga Autoriteti Kontraktues. Duke e konsideruar si një rekomandim të drejtë për tu shtuar në kontratat aktuale dhe/apo të ardhshme të investimeve dhe shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit, ANEKSI 1 PËR ELEMENTËT E MARRËVESHJES SË NIVELIT TË SHËRBIMIT (MNSH), duhet theksuar se mungesa vjen si rezultat se Udhëzimi Nr.1159 datë 17/03/2014 "Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit Të Shërbimit, në pikën 7 të tij ngarkon të gjitha institucionet e qeverisjes qendrore për zbatimin e tij, duke mos specifikuar domosdoshmërisht institucionet e qeverisjes vendore, ndër të cilat bën pjesë bashkia e Shkodrës.

"Shërbim Interneti", procedurë prokurimi e filluar përmes marrjes së angazhimit me nr.1522/b datë 23/04/2019, por për shkak të ankimimeve të dërguara në KPP, kontrata e shërbimit me nr.7763/28 Prot është nënshkruar me datë 10/01/2020. Kjo kontratë nuk ka qenë dhe nuk është detyrë funksionale e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse apo e Sektorit TIK. Në kontratë, në Nenin 36 - Përfaqësimi i Palëve, për institucionin është përcaktuar z. J.H si person përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kontratës. Në zbatim të këtij neni, z. J.H ka mbi këqyrur zbatimin e kontratës dhe cilësinë e ofrimit të shërbimit, si dhe ka kryer procedurën e marrjes në dorëzim të shërbimit, duke thirrur komisionin e marrjes në dorëzim të shërbimit, në zbatim të Urdhrit të Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë nr.27 datë 14/01/2020 "Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e specifikimeve teknike, testimin të tregut, llogaritjes së fondit limit, hartimit të preventivave, marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, ndjekjes së zbatimit të kontratave për procedurat e prokurimit publik", dhe operatorin ekonomik për ofrimin e shërbimit I shpk, duke siguruar cilësinë e ofrimit të shërbimit në zbatim të dokumentit të specifikimeve teknike të kësaj procedure, të dokumentuar përmes procesverbaleve 1 mujore të marrjes në dorëzim (të cilët në përmbajtjen e tyre kanë të dhëna të ngjashme me ato që kërkohen nga pika 8, germa d dhe dh e udhëzimit), deri në përfundimin e saj datë 31.12.2019. Gjithashtu është plotësuar dhe dorëzuar pranë APP edhe FORMULARI I RAPORTIMI PËR ZBATIMIN E KONTRATËS, në përfundim të saj. Mungon matja e cilësisë së shërbimit, si dhe përpilimi i raporteve të shërbimit dhe të vlerësimeve mbi performancën e shërbimit në përputhje me Udhëzimin Nr.1159 datë 17/03/2014 "Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit Të Shërbimit "pika 8 d, dh, për sa kohë nuk ka qenë e specifikuar në asnjërin nga nenet e kontratës së shërbimit dhe në detyrimet e personit përgjegjës për ndjekjen e saj, z. J.H, nga Autoriteti Kontraktues. Duke e konsideruar si një rekomandim të drejtë për tu shtuar në kontratat aktuale dhe/apo të ardhshme të investimeve dhe shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit, ANEKSI 1 PËR ELEMENTËT E MARRËVESHJES SË NIVELIT TË SHËRBIMIT (MNSH), duhet theksuar se mungesa vjen si rezultat se Udhëzimi Nr.1159 datë 17/03/2014 "Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit Të Shërbimit, në pikën 7 të tij ngarkon të gjitha institucionet e qeverisjes qendrore për zbatimin e tij, duke mos specifikuar

domosdoshmërisht institucionet e qeverisjes vendore, ndër të cilat bën pjesë bashkia e Shkodrës.

Për vitin 2020

Marrja e angazhimit për procedurën e prokurimit "Mirëmbajtje e faqes zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj" me nr.2972/b Prot është dërguar me datë 23/09/2020 për arsye të pezullimeve të procedurave të prokurimeve publike për shkak të gjendjes së emergjencës në Republikën e Shqipërisë si pasojë e pandemisë COVID-19. Për këtë arsye, marrëveshja kuadër 3-vjecare " Mirëmbajtje e faqes zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj" me nr. 13988/11 Prot është nënshkruar me datë 19/11/2020 dhe kontrata e shërbimit nr.1 me nr. 13988/12 Prot është nënshkruar me datë 19/11/2020. Përpilimi i marrëveshjes kuadër dhe kontratës së shërbimit nr.1 nuk ka qenë dhe nuk është detyrë funksionale e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse apo e Sektorit TIK. Në kontratë, në Nenin 36 - Përfaqësimi i Palëve , për institucionin është përcaktuar z.J.H si person përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kontratës. Në zbatim të këtij neni , z. J.H ka mbi këqyrur zbatimin e kontratës dhe cilësinë e ofrimit të shërbimit, si dhe ka kryer procedurën e marrjes në dorëzim të shërbimit, duke thirrur komisionin e marrjes në dorëzim të shërbimit, në zbatim të Urdhrit të Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë nr.27 datë 14/01/2020 "Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e specifikimeve teknike, testimin të tregut, llogaritjes së fondit limit, hartimit të preventivave, marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, ndjekjes së zbatimit të kontratave për procedurat e prokurimit publik", dhe operatorin ekonomik për ofrimin e shërbimit A shpk, duke siguruar cilësinë e ofrimit të shërbimit në zbatim të dokumentit të specifikimeve teknike të kësaj procedure, të dokumentuar përmes procesverbaleve 1 mujore të marrjes në dorëzim (të cilët në përmbajtjen e tyre kanë të dhëna të ngjashme me ato që kërkohen nga pika 8, germa d dhe dh e udhëzimit), deri në përfundimin e saj datë 31.12.2019. Gjithashtu është plotësuar dhe dorëzuar pranë APP edhe FORMULARI I RAPORTIMI PËR ZBATIMIN E KONTRATËS, në përfundim të saj. Mungon matja e cilësisë së shërbimit, si dhe përpilimi i raporteve të shërbimit dhe të vlerësimeve mbi performancën e shërbimit në përputhje me Udhëzimin Nr.1159 datë 17/03/2014 "Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit Të Shërbimit "pika 8 d, dh, për sa kohë nuk ka qenë e specifikuar në asnjërin nga nenet e kontratës së shërbimit dhe në detyrimet e personit përgjegjës për ndjekjen e saj, z. J.H, nga Autoriteti Kontraktues. Duke e konsideruar si një rekomandim të drejtë për tu shtuar në kontratat aktuale dhe/apo të ardhshme të investimeve dhe shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit, ANEKSI 1 PËR ELEMENTËT E MARRËVESHJES SË NIVELIT TË SHËRBIMIT (MNSH), duhet theksuar se mungesa vjen si rezultat se Udhëzimi Nr.1159 datë 17/03/2014 "Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit Të Shërbimit, në pikën 7 të tij ngarkon të gjitha institucionet e qeverisjes qendrore për zbatimin e tij, duke mos specifikuar domosdoshmërisht institucionet e qeverisjes vendore, ndër të cilat bën pjesë bashkia e Shkodrës.

Marrja e angazhimit për procedurën e prokurimit "Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Bashkisë Shkodër" me nr.538/b e dërguar me datë 19/02/2020 është pezulluar për arsye të gjendjes së emergjencës në Republikën e Shqipërisë si pasojë e pandemisë COVID-19. Për këtë arsye, marrëveshja kuadër 3-vjecare "Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Bashkisë Shkodër" me nr.3724/16 Prot është nënshkruar me datë 17/06/2020 dhe kontrata e shërbimit nr.1 me nr.3724/18 Prot është nënshkruar me datë 01/07/2020. Përpilimi i marrëveshjes kuadër dhe kontratës së shërbimit nr.1 nuk ka qenë dhe nuk është detyrë funksionale e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse apo e Sektorit TIK. Në kontratë, në Nenin 36 - Përfaqësimi i Palëve, për institucionin është përcaktuar znj.H.S si person përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kontratës. Në zbatim të këtij neni, znj. H.S ka

mbikëqyrur zbatimin e kontratës dhe cilësinë e ofrimit të shërbimit, si dhe ka kryer procedurën e marrjes në dorëzim të shërbimit, duke thirrur komisionin e marrjes në dorëzim të shërbimit, në zbatim të Urdhrit të Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë nr.27 datë 14/01/2020 Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e specifikimeve teknike, testimin të tregut, llogaritjes së fondit limit, hartimit të preventivave, marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, ndjekjes së zbatimit të kontratave për procedurat e prokurimit publik", dhe bashkimit të operatorëve ekonomik për ofrimin e shërbimit E.Xh-PF dhe S.P shpk, duke siguruar cilësinë e ofrimit të shërbimit në zbatim të dokumentit të specifikimeve teknike të kësaj procedure, të dokumentuar përmes procesverbalit përfundimtar të marrjes në dorëzim (të cilët në përmbajtjen e tyre kanë të dhëna të ngjashme me ato që kërkohen nga pika 8, germa d dhe dh e udhëzimit), në përfundimin e kontratës së shërbimit nr.1 datë 31.12.2020. Për arsye të pandemisë, numrit të kufizuar të punonjësve fizikisht prezent në punë gjatë periudhës së zbatimit të kontratës në vitin 2020, është bërë një procedurë finale e marrjes në dorëzim të shërbimit. . Gjithashtu është plotësuar dhe dorëzuar pranë APP edhe FORMULARI I RAPORTIMI PËR ZBATIMIN E KONTRATËS, në përfundim të saj. Mungon matja e cilësisë së shërbimit, si dhe përpilimi i raporteve të shërbimit dhe të vlerësimeve mbi performancën e shërbimit në përputhje me Udhëzimin Nr.1159 datë 17/03/2014 "Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit Të Shërbimit " pika 8 d, dh, për sa kohë nuk ka qenë e specifikuar në asnjërin nga nenet e kontratës së shërbimit dhe në detyrimet e personit përgjegjës për ndjekjen e saj, z. J.H, nga Autoriteti Kontraktues. Duke e konsideruar si një rekomandim të drejtë për tu shtuar në kontratat aktuale dhe/apo të ardhshme të investimeve dhe shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit, ANEKSI 1 PËR ELEMENTËT E MARRËVESHJES SË NIVELIT TË SHËRBIMIT (MNSH), duhet theksuar se mungesa vjen si rezultat se Udhëzimi Nr.1159 datë 17/03/2014 "Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit Të Shërbimit, në pikën 7 të tij ngarkon të gjitha institucionet e qeverisjes qendrore për zbatimin e tij, duke mos specifikuar domosdoshmërisht institucionet e qeverisjes vendore, ndër të cilat bën pjesë bashkia e Shkodrës.

3.3 Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Në Nenin 23 "Ndërprerja për Mosplotësim" të Shtojcës 15, Kushtet e Përgjithshme Shërbime-Kërkesë për Propozim, citohet

"Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,

Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës"

dhe për të arritur në këtë pikë duhet që A.K. të kryejë matjen e cilësisë së shërbimit dhe përpilimin e raporteve të shërbimit dhe meqenëse se kontratat e mësipërme janë kontrata me bazë MNSH-në atëherë ju cituam udhëzimin nr.1159 datë 17.03.2014 "Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit Të Shërbimit " ku sqarohet me saktë kryerja e këtyre raporteve.

Përsa i përket pikës 7 të udhëzimit nr.1159 datë 17.03.2014 "Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit Të Shërbimit" është sqaruar në Qëndrimin e Grupit të Auditimit nr. 1.1.

Grupi i auditimit, nisur sa më sipër dhe pasi shqyrtoi me vëmendje këtë observacion konkludoi se konstatimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

III.2.4. Auditimi i Sistemeve

Gjatë viteve të fundit, Bashkia Shkodër ka implementuar disa sisteme informacioni të integruara me qëllim ofrimin e shërbimeve elektronike ndaj qytetarëve, rritjen e shkallës së përdorimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit për ofrimin e këtyre shërbimeve, uljen e kostove dhe përmirësimin e cilësisë, rritjen e të ardhurave vendore dhe menaxhimin e tyre, përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies, identifikimin e shtresave sociale dhe shërbimeve që marrin, etj.

Në vitin 2017 ka përfunduar shtrirja e Sistemit të Integruar të Zyrave me Një Ndalesë (SiZIN) në të gjitha Njësitë Administrative dhe 5 Lagjet. Përmes këtij sistemi Bashkia Shkodër ofron për qytetarët 84 shërbime, prej të cilëve disa ofrohen pa pagese dhe disa të tjerë ofrohen kundrejt tarifave të miratuara në Paketën Fiskale. Faturimi bëhet përmes Sistemit të Integruar të Taksave dhe Tarifave Vendore (SiTTV). Po ashtu edhe kontrolli i shlyerjes së detyrimeve vjetore për bizneset apo individët para përfitimit të shërbimeve administrative të ofruara përmes SiZIN, bëhet nga specialistët e drejtorisë së të Ardhurave të cilët aksesojnë SiTTV. Sistemi i integruar i Taksave dhe Tarifave Vendore funksionon duke ofruar për përdoruesit dhe qytetarët :

1. Qasjen e përdoruesve në aplikacionin : Portali i taksapaguesit; (tax.ishkodra.net)
2. Llogaritjen automatike të detyrimeve dhe gjenerimin i njoftimeve;
3. Gjenerimin automatik të faturave
4. Regjistrimin e pagesave
5. Faturimin e Individeve;
6. Verifikimin automatik për shlyerjen e detyrimeve vendore ne SiZIN dhe faturimin e shërbimeve me pagesë.

SiTTV i integruar me SiZIN, janë të ngritur në platformën Smartprocesses në web app dhe së fundmi janë azhurnuar edhe në mobile app (iShkodra).

Ky aplikacion ka për qëllim dhënien e mundësisë për qytetarët dhe bizneset të aplikojnë nga çdo vendndodhje, nga smartphone-i apo tableti i tyre për disa shërbime administrative që ofrohen përmes ZiIN apo të llogarisin e të tërheqin faturat e detyrimeve vjetore vendore.

Bashkia Shkodër ka në përdorim një tjetër platformë online “Transaprenca e Buxhetit”, i cili është një instrument Open Data që informon qytetarët për të ardhurat vjetore të saj, shpenzimet dhe investimet, si dhe llogaritjen e taksave dhe tarifave vjetore të qytetarëve dhe bizneseve. Në këtë platformë Bashkia Shkodër publikon të dhënat mbi të ardhurat në të gjithë territorin e Bashkisë, çdo shpenzim apo investim të bërë sipas programeve buxhetore (vlera të parashikuara, vlera të realizuara, datë fillimi dhe mbarimi e shërbimit/investimit, operatori ekonomik fitues i procedurës së prokurimit, foto ilustruese pas përfundimit dhe dorëzimit të shërbimit apo investimit, mundësinë e marrjes së sugjerimeve nga qytetarët) për çdo vit kalendarik të detajuar sipas programeve buxhetore. Çdo e dhënë e bërë publike gjeolokalizohet në hartën e Bashkisë Shkodër e mbështetur mbi platformën Google Maps. Instrumenti azhurnohet vazhdimisht nga të gjithë drejtuesit e programeve buxhetore në varësi të gjendjes (statusit) në të cilin ndodhen procedurat (planifikuar = ikonë gjeolokalizuese e kuqe, në proces = ikonë gjeolokalizuese e verdhë, apo realizuar = ikonë gjeolokalizuese e gjelbër), si dhe çdo 3-mujor raportohet në total me të ardhurat e mbledhura apo të transferuara dhe shpenzimet e realizuara. Ky instrument është i ndërtuar mbi platformën Smartprocesse në web app.

Në vitin 2019 Bashkia Shkodër ka implementuar një sistem informacioni për Shërbimet Sociale. Qëllimi kryesor i implemetimit të këtij sistemi është ofrimi i mundësisë për të populluar një bazë të dhënash të saktë me informacione mbi institucionet që ofrojnë shërbime sociale, si dhe mbi përfituesit që janë të regjistruar pranë këtyre institucioneve, në nivel vendor. Baza e të dhënave konsiston në identifikimin, regjistrimin dhe koordinimin e shërbimeve sociale që ofrohen në territor si dhe regjistrimin e përfituesve të të gjitha kategorive për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve në territorin administrativ. Baza e të dhënave përfshin modulet e mëposhtme:

1. Ofruesit e shërbimeve sociale vendore, brenda territorit të Bashkisë Ofruesit e shërbimeve sociale vendore, jashtë territorit të Bashkisë;
2. Regjistri i përfituesve të shërbimeve sociale vendore Aplikues në proces

Edhe ky sistem është i ndërtuar mbi platformën web S.P dhe mund të aksesohet nga të gjithë përdoruesit në bashkinë Qendër apo në Qendrat Komunitare përmes shërbimit të internetit.

1. Titulli i Gjetjes: Mungesë e bazës rregullore në lidhje me menaxhimin e të dhënave, të drejtat dhe menaxhimin e përdoruesve të Sistemit të Integruar të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe të Sistemit të Zyrës me Një Ndalesë.

Situata: Nga auditimi u konstatua se bashkia Shkodër nuk disponon një politikë/rregullore të dokumentuar dhe miratuar për procesin e menaxhimit të përdoruesve (*krijimi, fshirja, ndryshimi i roleve/të drejtave, ndryshimi i fjalëkalimeve etj.*) për sistemet SZIN dhe SiTTV.

Nga intervistimi i stafit IT të Bashkisë është konstatuar se Bashkia Shkodër ndjek një procedurë të dakordësuar verbalisht për menaxhimin e përdoruesve sipas së cilës, struktura IT e Bashkisë merr kërkesat nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe strukturat e tjera të bashkisë, dhe përmes e-mailit komunikon me operatorin ekonomik i cili në bazë të kontratës së lidhur është përgjegjës për mirëmbajtjen e sistemit, i cili menaxhon përdoruesin për të cilin ka ardhur kërkesa dhe ja komunikon kredencialet përmes email-it në njësisë IT pranë Bashkisë Shkodër. Më pas, njësisia IT pranë Bashkisë Shkodër i komunikon kredencialet punonjësit i cili është përdoruesi fundor.

Bashkia Shkodër administron një përdorues me rolin ‘Administrator’ për Sistemin e Zyrës me Një Ndalesë dhe një përdorues me rolin ‘Administrator’ për Sistemin e integruar të Taksave dhe Tarifave Vendore’, kredencialet e të cilëve posedohen nga të gjithë punonjësit e Sektorit të Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të ZIN, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit. Bashkia Shkodër nuk disponon ndonjë dokumentacion për përcaktimin e administratorëve të sistemeve dhe kredencialet e sipërpërmendur nuk janë të dokumentuar dhe nuk ekziston një politikë e miratuar për menaxhimin dhe mbrojtjen e tyre.

Sistemi i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Sistemi i Zyrës me Një Ndalesë kanë politika dhe procedura teknike të vendosura për menaxhimin e gabimeve të përdoruesve, por Bashkia Shkodër nuk ka një politikë të miratuar dhe nuk ka të dokumentuar në manualët përkatës procedurat që duhen ndjekur administrativisht për menaxhimin e gabimeve.

Kriteri: Ligji 2/2017 ‘Për Sigurinë Kibernetike’; Neni 27, Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ‘Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale’, i ndryshuar; VKM Nr. 710, datë 21.08.2013 ‘Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit’, i ndryshuar;

Ndikimi/Efekti: Mos përcaktim dhe mosnjohje e të drejtave dhe detyrimeve që kanë të gjithë përdoruesit e sistemit SiTTV dhe SZIN. Pamundësi për përcaktimin e përgjegjësive të punonjësve në lidhje me administrimin, përdorimin dhe shfrytëzimin e sistemeve të informacionit.

Shkaku: Mungesa e planeve të mirë përcaktuara për zhvillimin e teknologjisë së informacionit dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

1. Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër të marrin masa për hartimin dhe miratimin e rregulloreve përkatëse për funksionimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit të cilët ka në përdorim institucioni, në të cilat të jenë të pasqyruara saktë përgjegjësitë, detyrat dhe të drejtat për menaxhimin e përdoruesve të këtyre sistemeve. Në rregullore të përcaktohet edhe politika për menaxhimin e gabimeve njerëzore dhe teknike në lidhje me përdorimin e sistemeve të IT.
2. Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër të marrin masa për përcaktimin e administrator-it/ëve të sistemeve të teknologjisë së informacionit që Bashkia Shkodër ka në përdorim. Detyrat. Përgjegjësitë dhe të drejtat e administratorit të sistemeve IT përcaktohen në rregulloren përkatëse të sistemit.

2. Titulli i Gjetjes: Mungesë e masave organizative dhe teknike në lidhje me sigurinë e të dhënave.

Situata: Nga auditimi u konstatua se:

-Në Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore, ekzistojnë aktiv në sistem tre përdorues, të cilët në bazë të Vendimit Nr. 2, Datë 05.01.2021, të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, nuk janë pjesë e strukturës së Bashkisë Shkodër.

Gjithashtu, në listën e përdoruesve të vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga Bashkia Shkodër, ekzistojnë aktiv, katër përdorues me kredenciale gjenerike (teardhurat.dajc@shkodra.work, teardhurat.berdice, teardhurat.gurizi, teardhurat.rrethina), kredencialet e të cilëve nuk janë të dokumentuar se nga cilët punonjës të Bashkisë apo njësive administrative posedohen dhe përdoren.

-Sistemi i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Sistemi i Zyrës me Një Ndalesë aksesohen nga rrjeti i Bashkisë Shkodër dhe nga njësitet administrative përmes web app, duke përdorur nivelin e autentifikimit me emër llogarie dhe fjalëkalim. Web app i SZIN dhe SiTTV nuk rezultojnë të kenë të instaluar certifikata SSL (Secure Socket Layer) të cilat shërbejnë për transmetimin e informacionit 'client-server-client' në mënyrë të enkriptuar.

-Bashkia Shkodër nuk ndjek një politikë të përcaktuar për analizimin e gjurmëve të auditimit për veprimet që kryejnë përdoruesit në Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Sistemin e Zyrës me Një Ndalesë. Në bazën e të dhënave të këtyre dy sistemeve ruhen gjurmët e auditimit (audit trail) për veprimet e kryera nga përdoruesit, por nuk ekzistojnë procedura për analizimin e këtyre gjurmëve. Në Sistemin e Zyrës me Një Ndalesë, përdoruesi me të drejta 'Administrator' ka akses në një ndërfaqe në të cilën mund të gjurmojë veprimet që janë kryer me një praktikë të caktuar por jo të gjithë veprimet që kryen nga përdoruesit e sistemit. Të dy këta sisteme, ruajnë në bazën e të dhënave gjurmët e auditimit (audit trail) në të cilat ruhet informacioni i plotë për veprimet që janë kryer nga përdoruesit e sistemit, por Bashkia Shkodër nuk kryen analizime periodikë të gjurmëve të auditimit të veprimeve, me qëllim evidentimin dhe parandalimin e problematikave të ndryshme që lidhen me sigurinë e informacionit dhe mirëfunksionimin dhe mirë përdorimin e këtyre dy sistemeve.

-Sistemi i Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe Sistemi i Zyrave me Një Ndalesë, janë të aksesueshëm përmes rrjetit Wifi të Bashkisë Shkodër. Këto dy sisteme, janë të dedikuara për përdorim nga punonjës të autorizuar për të kryer veprime me to, të cilët janë të pajisur me kompjutera të lidhur në rrjetin LAN të Bashkisë Shkodër apo përmes Virtual Private Network dhe aksesimi i tyre përmes rrjetit Wifi të Bashkisë Shkodër, ambiente të cilët aksesohen edhe nga persona të tjerë përveç punonjësve të Bashkisë, përmban risk për problematika në lidhje me sigurinë e informacionit të këtyre sistemeve.

Kriteri: Ligji 2/2017 'Për Sigurinë Kibernetike'; Neni 27, Ligji Nr. 9887, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar; VKM Nr. 710, datë 21.08.2013 "Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit", i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti:

- Risk për ndërhyrje të jashtme, me pasojë dëmtimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit.
- Risk për kryerjen e veprimeve në sistem nga persona të paautorizuar.
- Risk për mos-evidentimin dhe mos-parandalimin e problematikave që lidhen me sigurinë e të dhënave.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

1. Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër, në bashkëpunim me strukturën e teknologjisë së informacionit të marrin masa për analizimin e hollësishëm të të gjithë përdoruesve aktivë në sistemet që ka në përdorim Bashkia Shkodër me të drejta në sistem sipas pozicioneve të punës. Pas analizimit dhe evidentimit të të gjithë përdoruesve, të merren masa për bllokimin

e aksesit dhe ç'aktivizimin e të gjithë përdoruesve të cilët në bazë të vendimeve të Kryetarit të Bashkisë nuk janë më punonjës të institucionit.

2. Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër, në bashkëpunim me strukturën e teknologjisë së informacionit të marrin masa për minimizimin e rasteve të krijimit të përdoruesve me kredenciale gjenerike. Nëse do të përdoren të tillë, të përcaktohet me Urdhër të veçantë se cili punonjës do të posedojë dhe do të përdorë këto kredenciale.
3. Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër, në bashkëpunim me strukturën e teknologjisë së informacionit të marrin masa për aplikimin e certifikatave të sigurisë SSL (Secure Socket Layer) për SiTTV dhe SZIN në web app.
4. Struktura e teknologjisë së informacionit, të marrin masa për bllokimin e mundësisë për aksesimin e SiTTV dhe SZIN nga rrjeti Wifi i Bashkisë Shkodër.
5. Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër, në bashkëpunim me strukturën e teknologjisë së informacionit të marrin masa për hartimin dhe miratimin e një politike të mirë dokumentuar për analizimin periodik të gjurmëve të auditimit të veprimeve të kryera në sistemet IT me qëllim evidentimin dhe parandalimin e problematikave të mundshme në lidhje me mirëfunksionimin dhe mirë përdorimin e sistemeve IT të Bashkisë Shkodër.

3. Titulli i Gjetjes: Mungesë e masave organizative dhe teknike në lidhje me plotësinë dhe integritetin e të dhënave të sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Situata: Nga auditimi i bazës së të dhënave të Sistemit të Integruar të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Sistemit të Zyrës me Një Ndalesë rezulton se këta dy sisteme kanë nevojë për përmirësime në drejtim të garantimit të integritetit dhe plotësisë së të dhënave që krijohen, menaxhohen dhe ruhen përmes tyre. Më konkretisht situata e konstatuar rezulton të jetë si më poshtë vijon:

- Sistemi i Integruar i Taksave dhe Tarifave Vendore:

1. Në tabelën e faturave 'Invoices', në 3 raste, fusha 'Nipt' është plotësuar me vlerën 's'ka', në 4 raste është plotësuar me vlerën '#32955', në 1 rast me vlerën '123456', dhe në 1 rast me vlerën '6278356286' dhe në 114466 raste është NULL. Në këtë tabelë, në 6757 raste, fusha 'Amount' ka vlerë më të vogël se 0 dhe në 103 raste ka vlerën '0'.
2. Në tabelën në të cilën ruhen emrat e administratorëve të bizneseve, 'EmraAdmin', në 3158 raste, nga 5309 administratorë të regjistruar gjithsej, fusha 'Atësia' është identike me fushën 'Mbiemri'. Ky fakt mund të përbëjë pengesë për identifikimin e saktë të administratorëve të bizneseve dhe për këtë arsye duhet të shtohet një kontroll që këto fusha të mos plotësohen me vlerë të njëjtë.
3. Në tabelën në të cilën ruhen pagesat e kryera, 'Payment', në 1 rast ku pagesa është kryer përmes bankës, fusha 'PaymentInstitutionName', fushë në të cilën ruhet banka në të cilën është kryer pagesa, ka vlerën 'NULL', në 1 rast ku pagesa është kryer përmes veprimt 'Xhirim', fusha 'PaymentInstitutionName' ka vlerën 'NULL'.
4. Në tabelën në të cilën ruhen pagesat e kryera, 'Payment', rezulton se në 19 raste, rekordi i regjistruar në bazën e të dhënave për pagesat e kryera, në fushën shuma ka vlerën '0' dhe në 548 raste ka vlerë negative, pra më të vogël se 0.
5. Në tabelën në të cilën ruhen raportet për akt kontrollit e kryera, në 1 rast fusha 'NIPT' ka vlerën '-', në 1 rast ka vlerën '0000560', në 1 rast ka vlerën '0001336', në 1 rast ka vlerën '0001459', në 1 rast ka vlerën '0340', në 1 rast ka vlerën 'Osmani', në 2 raste ka vlerën 'S'ka' dhe në 1 rast ka vlerën 'Shiroke'.

Problematikat e konstatuara më sipër pasqyrohen në Aneksin II.

- Sistemi i Zyrës me Një Ndalesë:

1. Në tabelën ku ruhen të dhënat e bizneseve që kanë përdorur dhe përdorin këtë sistem, 'BusinessDetails', në 4 raste fusha 'NIPT' ka vlerën 'Null', në 19 raste fusha

‘EmriSubjektit’ ka vlerën ‘NULL’, në 1 rast fusha ‘Lloj Aktiviteti’ ka vlerën ‘-Zgjidhni-’ dhe jo ‘Person Fizik’ ose ‘Person Juridik’.

2. Në tabelën ku ruhen aplikimet e kryera për marrjen e shërbimeve nga Bashkia Shkodër përmes Sistemit të Zyrës me Një Ndalesë, ‘Aplikime’ janë regjistruar gjithësej 160,164 aplikime, për periudhën 24.11.2015 – 16.06.2021, prej të cilëve 6994 rezultojnë me status ‘Të fshirë’ – ‘Trashed’. (Për këto raste, sistemi duhet të kërkojë plotësimin e një fushe, për të përshkruar arsyen e fshirjes të çështjes).
3. Në tabelën kur ruhen gjurmët e një praktike për një aplikant të caktuar, ‘GetApplicantHistory’, në 23 raste, fusha ‘DataKerkeses’ ka vlerën NULL, dhe në 7 raste fusha ‘NrPraktike’ është bosh.
4. Në tabelën ku ruhen aplikimet e kryera, ‘Aplikime’, rezulton që 666 aplikime të jenë kryer nga Useri ‘admin’, ç’ka përmban risk për pamundësi të gjurmimit të veprimeve të kryera duke qenë se nuk ka një rregullore të përcaktuar në të cilën të jetë sanksionuar se cilët punonjës duhet të posedojnë kredencialet e këtij përdoruesi.

Problematikat e konstatuara më sipër pasqyrohen në Aneksin III.

Kriteri: Ligji 2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”; Neni 27, Ligji Nr. 9887, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar; VKM Nr. 710, datë 21.08.2013 “Për Krijimin dhe Funkcionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Risk për mos-garantimin e plotësisë dhe integritetit të të dhënave të sistemeve IT.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

Struktura e teknologjisë së informacionit, të marrë masa për analizimin e situatës aktuale në lidhje me integritetin dhe plotësinë e të dhënave që përmbajnë sistemet informatike të Bashkisë Shkodër duke përcaktuar edhe shkaqet prej të cilëve rrjedhin problematikat e konstatuara. Të merren masat e nevojshme për ngritjen dhe implementimin e mekanizmave të kontrollit dhe validimit të inputit të sistemeve informatike, duke përcaktuar dhe kornizuar tipin e të dhënave që mund të plotësojnë përdoruesit në përputhje me formatin dhe informacionin që përmban secila prej fushave, me qëllim parandalimin e përsëritjes së problematikave të konstatuara.

Për sa është konstatuar më lart, mbi auditimin e sistemeve, mbajnë përgjegjësi znj. V.A në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë sipas detyrave funksionale të përcaktuara në zbatim të neneve 3, 4, 7, 59 dhe nenit 64 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe z. Gj.K në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së të Ardhurave, znj. A.P në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, dhe z. J.H, z. P.M, znj. S.D në cilësinë e specialistit të sektorit të administrimit të sistemeve, menaxhimit të ZIN, projekteve TIK dhe menaxhimit të sistemeve të informacionit, sipas detyrave funksionale të përcaktuara në zbatim të neneve 65 dhe 66 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme, “Për miratimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Shkodër” miratuar me vendimin nr. 96, datë 20.03.2017 të Kryetarit të Bashkisë.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 5, datë 16.07.2021, protokolluar në Bashkinë Shkodër me nr. 7670/7 datë 16.07.2021 si dhe është trajtuar në faqet 35-40 të Projektraportit të Auditimit mbi të cilin nuk janë paraqitur observacione.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Planit i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Shkodër për vitet 2015-2030 nuk përcakton politika shteruese për veprimtarinë mbi Teknologjinë e Informacionit. Kjo strategji është hartuar si një strategji ndër sektoriale gjithëpërfshirëse e Bashkisë në nivel makro. Ky dokument strategjik nuk është përditësuar me ndryshimet që ka pësuar Bashkia për një periudhë 6 vjeçare në lidhje me teknologjinë e informacionit.

Nga auditimi mbi masat e marra për plotësimin objektivave të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë 2015-2030 u konstatua se nuk ka indikatorë të matshëm për plotësimin e këtyre objektivave dhe nuk flitet për element konkret dhe mënyrën se si do të arrihet përmbushja e këtyre objektivave

Gjithashtu, duke pasur parasysh që Planit i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë është hartuar për një periudhë 15 vjeçare do të ishte e nevojshme hartimi i një plan-veprimi për strategjinë si dhe përcaktimin e indikatorëve të matjes së performancës së strategjisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (12-24) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Bashkia Shkodër duke patur parasysh ndryshimet strukturore dhe infrastrukturore të ndodhura në institucion të marrë masa për përditësimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë për vitet 2015-2030 me element të teknologjisë së Informacionit dhe të bëjë rishikimin e këtij dokumenti strategjik çdo 5 vjet.

Gjithashtu strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme të marrin masa për përcaktimin e elementëve dhe indikatorëve të matshëm për matjen e plotësimin të objektivave të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se bashkia Shkodër nuk ka strategji për teknologjinë e informacionit, mungesa e të cilës sjell mos planifikim dhe mos pasqyrim të qartë të objektivave lidhur me infrastrukturën IT dhe sigurinë institucionale si dhe burimet e nevojshme për matjen e objektivave. Mungesa e planit strategjik, mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së bashkisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (12-24) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni posedon dhe përpunon, të marrin masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se rregullorja e brendshme, “Për miratimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Shkodër” miratuar me vendimin nr. 96, datë 20.03.2017 të Kryetarit të Bashkisë nuk është përshtatur (amenduar) duke mos reflektuar ndryshimet institucionale të ndodhura ndër vite në Bashkinë Shkodër. Në rregullore përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë duke ju referuar sektorit të administrimit të sistemeve dhe menaxhimit të zyrës së integruar me një ndalesë, por nuk përmenden fare Përgjegjësit, specialistët për sistemet e tjera si “Sistemi i Taksave dhe Tarifave Vendore; Sistemi i Shërbimit Social; Transparenca e Buxhetit”. Të gjithë këto sisteme nuk janë të reflektuar në Rregulloren e Brendshme duke mos përcaktuar elementë përkatës për të siguruar funksionim të përshtatshëm të strukturës IT në institucion.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (12-24) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Bashkia Shkodër dhe strukturat këshilluese mbi IT, të hartojë, amendojë dhe miratojë, rregulloren e brendshme, “Për miratimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Shkodër” duke reflektuar ndryshimet institucionale, strukturore dhe kompjuterike të ndodhura ndër vite në bashki. Hartimi i kësaj Rregulloreje të marrë në konsideratë vendosjen e kontroleve të brendshme lidhur me menaxhimin e riskut, përputhshmërinë me procedurat dhe rregullat e brendshme aktuale si dhe me legjislacionin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Shqipëri.

Brenda vitit 2021 dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

-Struktura e burimeve njerëzore në Sektori i Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të ZIN, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit është e paplotësuar sipas strukturës organike të përcaktuar.

-Bashkia Shkodër, nuk ka plan trajnimi vjetor për vitet 2019-2020 për burimet njerëzore të sektorit të Teknologjisë e Informacionit. Nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre. Trajnimet e përfituara nga ASPA apo zhvilluesit e sistemeve janë të pa mjaftueshme e nuk plotësojnë nevojat për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacioni për stafin IT.

-Për punonjësit e sektorit të Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të ZIN, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit nuk janë hartuar dhe miratuar përshkrimet e punës si dhe kriteret për kualifikimet e punonjësve për këtë sektor.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (12-24) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrin masa për menaxhimin e burimeve njerëzore, gjithashtu të marrin masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit IT dhe të çdo përdoruesi të sistemeve TIK si dhe të hartojë e miratojë plane dhe politika për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

Brenda vitit 2021 dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se funksionimi dhe organizimi i strukturës së IT-së në nivel sektori nën Drejtorinë e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse, nuk i përgjigjet shtrirjes së teknologjisë së informacionit në bashki dhe njërive të vartësisë duke sjellë uljen e ndikimit të IT-së në qeverisjen e bashkisë si dhe zbeh ndikimin e varësisë direkt nga menaxhimi i lartë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (12-24) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme të analizojnë mundësinë e ndryshimeve strukturore të strukturës ekzistuese IT me qëllim rritjen e rolit të saj dhe të marrin masa për ngritjen në nivel të strukturës së IT nga nivel sektori në nivel Drejtorie.

Brenda vitit 2021

6. Gjetje nga auditimi: Nga administrimi i dokumentacionit për identifikimin dhe menaxhimin e riskut në teknologjinë e informacionit, konstatohet se Bashkia disponon një regjistër rrisht të përgjithshëm për të gjithë institucionin, ku përfshihen edhe disa risqe mbi IT por nuk mbulohen të gjithë aktivitetet duke përfshirë këtu risqet mbi sistemin e tarifave dhe taksave, proceset e menaxhimit të ndryshimit, etj. Për periudhën nën auditim konstatohet se nuk është bërë përditësim i risqeve mbi TIK, në mospërputhje me: nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Udhëzimin nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”, UMF nr. 16, datë 20.07.2016

“Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (12-24) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër në bashkëpunim me strukturat këshilluese mbi TIK dhe sektorin TIK, të marrin masat e nevojshme për përditësimin dhe dokumentimin e regjistrit të risqeve dhe për hartimin dhe dokumentimin e një plani veprimi për minimizimin/ parandalimin e risqeve të identifikuara, si dhe të bëhet monitorimi periodik i zbatimit të këtyre masave.

Brenda vitit 2021 dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Për periudhën e audituar, u konstatua se bashkia Shkodër nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT, dhe në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh. Mbështetja teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit, kryhet nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (12-24) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandim: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Shkodër në bashkëpunim me sektorin TIK të marrin masa për identifikimin, dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve si dhe menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm në bashkinë Shkodër për vitet 2019-2020 nuk ka kryer asnjë auditim mbi sistemet e teknologjisë së informacionit, në kundërshtim me nenet 14 dhe 8 të Ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”. “Të kryejë auditime IT sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 6 dhe nenit 9 dhe në përputhje me Standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm.

Njësia e auditimit të brendshëm në Bashkinë Shkodër:

- në strukturën e saj nuk ka auditues me profil teknologji informacioni;
- ka akses por nuk shfrytëzon për auditim informacion nga sistemet informatike të bashkisë;
- nuk vlerëson nëse qeverisja e teknologjisë së informacionit në bashki mbështet strategjitë dhe objektivat institucionale.

Në këtë mënyrë, nuk ka një strukturë kontrolli të mirëfilltë për auditimin e teknologjisë së informacionit në bashkinë Shkodër, duke rritur riskun e mos identifikimit të parregullsive që mund të ndodhin në sisteme.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (12-24) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: Bashkia Shkodër të marrë masa për zhvillimin e burimeve njerëzore të Auditimit të brendshëm me njohuri të mjaftueshme mbi teknologjinë e informacionit dhe mbulimin me auditim të brendshëm IT të sistemeve IT, sektorit IT pranë bashkisë si dhe përdoruesit e sistemeve informatike në përputhje me përcaktimet ligjore.

Brenda vitit 2021 dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ambienti fizik i dhomës së serverëve në bashkinë Shkodër nuk është në përputhje me standardet e përcaktuara në rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve të miratuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (24-37) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: Bashkia Shkodër të marrë masa për ndërtimin e ambienteve të dhomës të server-ave në bazë të rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK si dhe në përputhje me udhëzimet, standardet dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

Brenda 6 muhorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Referuar pikave kryesore të sigurisë së informacionit në rrjetin privat dhe publik janë verifikuar konfigurimet e sigurisë mbi switch-et dhe firewall-in e institucionit, dhe nga verifikimi rezultoi se:

- Rrjeti i bashkisë nuk është i ndarë në rrjet privat dhe në rrjet publik (internet);
- Për konfigurimet aktuale për switch-et kryesore, nuk janë marrë masat e nevojshme që useri admin të limitohet në logimin vetëm nga IP-të brenda rrjetit privat dhe nuk është e bllokuar që useri admin të logohet nga jashtë rrjetit, pra nga një rrjet publik;
- Nuk janë krijuar zona me limite të caktuara për brenda LAN si dhe rrjeti nuk është i ndarë në VLAN (rrjete virtuale) çka do të bënte të mundur menaxhimin dhe lejimin e grupeve të IP-ve në shërbime të ndryshme sipas nevojave. Gjithashtu nuk është krijuar edhe një zonë Untrust e cila sipas konfigurimeve shërben për bllokimin e portave të shërbimeve si dhe bllokimin e IP-ve të cilat mund të paraqesin problematika ose sulme;
- Pajisjet switch aksesohen në çdo moment në qoftë se je lidhur në rrjetin e bashkisë dhe aksesimi i tyre realizohet me të njëjtat kredenciale të njëjlojta. Kjo gjë do të rrit mundësinë për sulme nga scripture/viruse;
- Koha e vendosur tek të gjitha switchet është manuale duke mos treguar kohën dhe datën reale të ndodhjes së një problematike, duke ndikuar në të dhënat e logeve, pasi çdo log dhe gjurmë e dokumentuar nuk ka të dhëna të sakta se çfarë date/ore ka ndodhur;
- Për administrimin e firewall nuk janë krijuar group users me nivele të ndara menaxhim/monitorim. Çdo veprim bëhet nga useri admin.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (24-37) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandim: Sektori TIK pranë bashkisë Shkodër të marrë masat e nevojshme për krijimin e konfigurimeve përkatëse në rrjetin e institucionit mbi logimin, konfigurimin dhe sigurinë e switch-ve dhe firewall-it. Të krijohen zona me limite të caktuara brenda LAN si dhe rrjeti të konfigurohet në VLAN (rrjete virtuale) për menaxhimin dhe lejimin e grupeve të IP-ve në shërbime të ndryshme sipas nevojave. Gjithashtu të merren masa për administrimin dhe implementimin e të gjitha konfigurimeve të nevojshme të evidentuara nga auditimi dhe të tjera të mundshme, me qëllim rritjen e sigurisë së infrastrukturës network.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe mbikëqyrja e faqes web u konstatua se:

- Portali nuk përdor një lidhje të sigurtë (connection security) HTTPS (HyperText Transfer Protocol Secure) (Not secure status) pra komunikimi ndërmjet web browser-it dhe serverit kryhet duke përdorur protokollin HTTP, që do të thotë se serveri i faqes së internetit nuk përdor një certifikatë sigurie për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletues.
- Në kuadrin e transparencës bashkia Shkodër ka afishuar në faqen e saj web, organigramën e institucionit, ku përfshihen, strukturat e të gjithë administratës dhe njësive administrative, statutin, kodin e etikës, rregulloren e brendshme, etj. Faqja web:
 - nuk ka të afishuar numrat e kontaktit dhe orarin e ofrimit të shërbimeve ndaj publikut;
 - tek menuja “shërbime dhe kontakte” ka të afishuar linkun e bashkisë që të dërgon te adresa faqes zyrtare të bashkisë në rrjetin social facebook.
 - nuk administrohet rregullore për faqen e web;
 - nuk realizohet monitorimi i statistikave të vizitorëve të faqes web (p.sh.me google analytics).
- faqja web vetëm në version shqip kufizon përdoruesit e kësaj faqeje dhe promovimin e shërbimeve dhe aseteve të kësaj bashkie.
- Në total janë zbuluar përkatësisht 17 dobësi të faqes së webit, në 4 nivele të ndryshme të riskut. Këto dobësi i ekspozojnë aplikacionet e prekura ndaj rrezikut të qasjes së paautorizuar në të dhënat konfidenciale dhe rrit mundësinë e sulmeve (denial of service).

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (24-37) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandimi: Bashkia Shkodër në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për mbarëvajtjen e faqes web, të marrin masa për përmirësimin e faqes web me elementët përkatës të sigurisë (certifikatën e sigurisë) së navigimit online për të rritur sigurinë si dhe të merren masa për përmirësimin dhe përditësimin e faqes web me (informacione, ligje, rregullore, akte, etj) për të rritur ndihmesën ndaj qytetarëve. Të reflektohen dobësitë e dala nga auditimi dhe të kihet parasysh që në të ardhmen të shtohen elementë inovativ në faqen web për ta bërë atë sa më interaktive dhe ndihmëse për qytetarët.

Brenda vitit 2021 dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se bashkia Shkodër, nuk rezulton të ketë, dokumentim/ implementim të politikave/planeve mbi sigurinë e informacionit dhe nuk disponon dokumentacion në lidhje me:

- Planet e vazhdueshmërisë së punës (BCP), në rastet e dështimit të dhomës së server-ave që suportojnë sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore sistemin e Zyrës me Një Ndalesë, sistemin e Shërbimit Social dhe transparenca e Buxhetit.

- Procedurat e rikthimit (restore) të të dhënave nuk testohen për t'u siguruar që ato janë të efektshme dhe që ato mund të ekzekutohen brenda kohës së lejuar për sistemet e sipërpërmendura.

- ruajtja e backup në vende jashtë godinës së bashkisë, në distancë nuk realizohet;

- nuk realizohet backup për loget e sistemit të hyrje-daljeve të personelit;

- pajisjet e rrjetit (switch dhe router), konfigurimet e tyre, nuk janë bërë backup;

- nuk është e qartë nëse kontrollohet statusi i backup-it nëse procedura është kryer me sukses;

- ruajtja e backup në google drive që nuk është në pronësi të bashkisë rrit cënueshmërinë e të dhënave dhe sigurinë e tyre. Në rast të përfundimit të kontratës së mirëmbajtjes me operatorin që ofron shërbimin, nuk është e përcaktuar se ku do të ruhet backup pas kësaj dhe si do ti kalojë backupi më i vjetër që ndodhet tashmë në drive-in e operatorit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (24-37) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në bashkinë Shkodër në bashkëpunim me sektorin e IT-së të marrin masa për ndërtimin dhe hartimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat.

Gjithashtu të merren masat e nevojshme që ruajtja e të dhënave dhe backup-eve të sistemeve të realizohet në memorie dhe hapësira virtuale që janë në pronësi të bashkisë me qëllim garantimin e sigurisë së informacionit dhe cenimin e të dhënave të sistemeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimeve për blerjet me vlerë të vogël, u konstatua se, në dy procedura prokurimi, në përbërje të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nuk janë përfshirë specialist të fushës së Teknologjisë së Informacionit. Konkretisht:

a)“Mirëmbajtje e faqes zyrtare web www.bashkiashkodër.gov.al dhe moduleve të integruara të saj” Viti 2019, procedurë prokurimi “Blerje me Vlerë të Vogël, me fond limit 250,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E “A.I” me ofertë 242,000 lekë pa TVSH;

b)“Mirëmbajtje pajisje informatike” Viti 2019, procedurë prokurimi “Blerje me Vlerë të Vogël, me fond limit 498,898 lekë pa TVSH, me fitues O.E “B.O.O” me ofertë 455,500 lekë pa TVSH.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (37-48) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1 Rekomandimi: Titullari i Institucionit dhe personat autorizues mbi hartimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, në procedurat e ardhshme, gjatë krijimi të Njësive të Prokurimit dhe të Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave, të bazohen në kornizat ligjore dhe rregullative dhe të përfshijnë minimumi një specialist të fushës përkatëse të procedurës së prokurimit.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për procedurën e prokurimit “Mirëmbajtje Pajisje Informatike” viti 2020, procedurë prokurimi “Blerje me Vlerë të Vogël”, me fond limit 264,961 lekë pa TVSH, me fitues O.E “B.O.O” me ofertë 251,400 lekë pa TVSH, pas verifikimit të dokumentacionit dërguar nga O.E. “B.O.O”, data e lëshimit të vërtetimit të shlyerjes së taksave dhe tarifave vendore mban datën 04.12.2020 nr.376 Prot., ndërkohë që afati i dërgimit të ofertave ka qenë data 25.11.2020 ora 12:00.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (37-48) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1 Rekomandimi: Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të kenë parasysh që gjatë vlerësimit të O.E pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, të bazohen në legjislacionin përkatës që të mos lejojnë asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në dokumentacion apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se procedurën e prokurimit “Shërbim GPS + Monitorim” viti 2019, procedurë prokurimi “Kërkesë për Propozim” me fond limit 510,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E “A” shpk me ofertë 510,000 lekë pa TVSH, pas verifikimit të dokumentacionit të procedurës së prokurimit rezulton që në Njësinë e Prokurimit dhe në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave asnjë nga anëtarët nuk është specialist i fushës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (37-48) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1 Rekomandimi: Titullari i Institucionit dhe personat autorizues mbi hartimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, në procedurat e ardhshme të prokurimit, gjatë krijimi të Njësive të Prokurimit dhe të Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave, të bazohen në kornizat ligjore dhe rregullative dhe të përfshijnë minimumi një specialist të fushës përkatëse të procedurës së prokurimit.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në disa procedura prokurimi kontratat e zbatimit nuk janë hartuar dhe lidhur sipas kërkesave të pikës 2, të VKM-së nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit” i ndryshuar, dhe sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 1159 datë 17.3.2014 “Për hartimin e marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit”, i ndryshuar, në të cilën cilësohet që kontratatave të llojeve të mësipërme duhet t’ju bashkëngjitet Aneksi nr.1 i MNSH (Marrëveshjes të Nivelit të Shërbimit). Konkretisht kjo shkelje është konstatuar në këto procedura prokurimi:

-“Mirëmbajtje e faqes zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj” viti 2019, procedurë prokurimi “Blerje me Vlerë të Vogël” me fond limit 250,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E “A.I” me ofertë 242,000 lekë pa TVSH;

-“Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Bashkisë Shkodër” viti 2019, procedurë prokurimi “Kërkesë për Propozim” me fond limit 2,168,333 lekë pa TVSH, me fitues O.E “E.Xh” me ofertë 2,107,917 lekë pa TVSH;

-“Shërbim GPS+Monitorim” viti 2019, procedurë prokurimi “Blerje me Vlerë të Vogël” me fond limit 510,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E “A-T-D” me ofertë 510,000 lekë pa TVSH;

-“Shërbim Interneti” viti 2019, procedurë prokurimi “Kërkesë për Propozim” me fond limit 1,750,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E “I” me ofertë 980,000 lekë pa TVSH;

-“Mirëmbajtje e faqes zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj”, viti 2020, procedurë prokurimi “Kërkesë për Propozim” me fond limit 750,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E “A.I” me ofertë 747,000 lekë pa TVSH;

-“Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Bashkisë Shkodër” viti 2020, procedurë prokurimi “Kërkesë për Propozim” me fond limit 7,144,989 lekë pa TVSH, me fitues O.E “E.Xh” me

ofertë 7,131,000 lekë pa TVSH. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (37-48) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

16.1 Rekomandimi: Titullari i Institucionit dhe personat autorizues mbi hartimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, në procedurat e prokurimit, me bazë shërbimet në Teknologjinë e Informacionit të kenë parasysh që në hartimin e kontratave të shërbimit të bazohen në legjislacionin e sipërpërmendur duke hartuar Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në dy raste, procedurat e prokurimit dhe kontratat e zbatimit janë realizuar me shumë vonesë, duke lenë pa mbuluar me shërbimin përkatës periudha kohore nga përfundimi i afatit të kontratës së mëparshme deri në lidhjen e kontratave të reja. Konkretisht:

-“Mirëmbajtje e faqes zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj” viti 2019, procedurë prokurimi “Blerje me Vlerë të Vogël” me fond limit 250,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E “A.I” me ofertë 242,000 lekë pa TVSH, data e lidhjes së kontratës është 09.04.2019 nr.4824/6, ndërkohë që afati i kontratës së mëparshme për të njëjtin shërbim ka përfunduar më datë 31.12.2018 dhe diapazoni kohor midis 01.01.2019-09.04.2019 mbetet pa shërbim;

-“Mirëmbajtje e faqes zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj” viti 2020, procedurë prokurimi “Kërkesë për Propozim” me fond limit 750,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E “A.I” me ofertë 747,000 lekë pa TVSH, data e lidhjes së kontratës është 19.11.2020, ndërkohë që afati i kontratës së mëparshme për të njëjtin shërbim ka përfunduar më datë 31.12.2019 dhe diapazoni kohor midis 01.01.2020-19.11.2020 mbetet pa shërbim. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (37-48) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

17.1 Rekomandimi: Personat autorizues mbi hartimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, në procedurat e prokurimit, me bazë shërbimet në Teknologjinë e Informacionit, në sistemet ekzistuese, të parashikojnë MNSH-në, kohëzgjatja e së cilës duhet të jetë jo më e shkurtër se 2 (dy) vjet.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, gjatë zbatimit të 6 kontratave nuk është kryer matja e cilësisë së shërbimit dhe mungojnë raportet e shërbimit dhe të vlerësimeve mbi performancën e shërbimit. Konkretisht kjo shkelje është konstatuar në këto kontrata:

-“Mirëmbajtje e faqes zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj” viti 2019, procedurë prokurimi “Blerje me Vlerë të Vogël” me fond limit 250,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E “A.I” me ofertë 242,000 lekë pa TVSH;

-“Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Bashkisë Shkodër” viti 2019, procedurë prokurimi “Kërkesë për Propozim” me fond limit 2,168,333 lekë pa TVSH, me fitues O.E “E.Xh” me ofertë 2,107,917 lekë pa TVSH;

-“Shërbim GPS + Monitorim” viti 2019, procedurë prokurimi “Blerje me Vlerë të Vogël” me fond limit 510,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E “A” me ofertë 510,000 lekë pa TVSH;

-“Shërbim Interneti” viti 2019, procedurë prokurimi “Kërkesë për Propozim” me fond limit 1,750,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E “I” me ofertë 980,000 lekë pa TVSH.

-“Mirëmbajtje e faqes zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj”, viti 2020, procedurë prokurimi “Kërkesë për Propozim” me fond limit 750,000 lekë pa TVSH, me fitues O.E “A.I” me ofertë 747,000 lekë pa TVSH;

-“Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Bashkisë Shkodër” viti 2020, procedurë prokurimi “Kërkesë për Propozim” me fond limit 7,144,989 lekë pa TVSH, me fitues O.E “E.Xh” me ofertë 7,131,000 lekë pa TVSH.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (37-48) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1 Rekomandimi: Personat autorizues mbi ndjekjen e zbatimit të kontratës të kryejnë matjen e cilësisë së shërbimeve dhe të kryejnë raporte periodike mbi ecurinë e shërbimit bazuar në kontratën e lidhur midis O.E dhe A.K.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se bashkia Shkodër nuk disponon një politikë/rregullore të dokumentuar dhe miratuar për procesin e menaxhimit të përdoruesve (krijimi, fshirja, ndryshimi i roleve/të drejtave, ndryshimi i fjalëkalimeve etj.) për sistemet SZIN dhe SiTTV.

Bashkia Shkodër nuk disponon bazë rregullatore në lidhje me menaxhimin e të dhënave, të drejtat dhe menaxhimin e përdoruesve të Sistemit të Integruar të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe të Sistemit të Zyrës me Një Ndalesë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (48-54) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër të marrin masa për hartimin dhe miratimin e rregulloreve përkatëse për funksionimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit të cilët ka në përdorim institucioni, në të cilat të jenë të pasqyruara saktë përgjegjësitë, detyrat dhe të drejtat për menaxhimin e përdoruesve të këtyre sistemeve. Në rregullore të përcaktohet edhe politika për menaxhimin e gabimeve njerëzore dhe teknike në lidhje me përdorimin e sistemeve të IT.

Menjëherë

19.2 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër të marrin masa për përcaktimin e administrator-it/ëve të sistemeve të teknologjisë së informacionit që Bashkia Shkodër ka në përdorim. Detyrat, përgjegjësitë dhe të drejtat e administratorit të sistemeve IT përcaktohen në rregulloren përkatëse të sistemit.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan mangësi mbi masat organizative dhe teknike në lidhje me sigurinë e të dhënave. Më konkretisht:

-Në Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore, ekzistojnë aktiv në sistem tre përdorues, të cilët në bazë të Vendimit Nr. 2, Datë 05.01.2021, të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, nuk janë pjesë e strukturës së Bashkisë Shkodër.

-Në listën e përdoruesve të vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga Bashkia Shkodër, ekzistojnë aktiv, katër përdorues me kredenciale gjenerike (teardhurat.dajc@shkodra.work, teardhurat.berdice, teardhurat.gurizi, teardhurat.rrethina), kredencialet e të cilëve nuk janë të dokumentuar se nga cilët punonjës të Bashkisë apo njërive administrative posedohen dhe përdoren;

-Bashkia Shkodër nuk ndjek një politikë të përcaktuar për analizimin e gjurmëve të auditimit për veprimet që kryejnë përdoruesit në Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Sistemin e Zyrës me Një Ndalesë. Në bazën e të dhënave të këtyre dy sistemeve ruhen gjurmët e auditimit (audit trail) për veprimet e kryera nga përdoruesit, por nuk ekzistojnë procedura për analizimin e këtyre gjurmëve;

-Bashkia Shkodër nuk kryen analizime periodikë të gjurmëve të auditimit të veprimeve, me qëllim evidentimin dhe parandalimin e problematikave të ndryshme që lidhen me sigurinë e informacionit dhe mirëfunksionimin dhe mirë përdorimin e këtyre dy sistemeve;

-Aksesimi i dy sistemeve (SZIN dhe SiTTV) përmes rrjetit Wifi të Bashkisë Shkodër, ambiente të cilët aksesohen edhe nga persona të tjerë përveç punonjësve të Bashkisë, përmban risk për problematika në lidhje me sigurinë e informacionit të këtyre sistemeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (48-54) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

20.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër, në bashkëpunim me strukturën e teknologjisë së informacionit të marrin masa për analizimin e hollësishëm të të gjithë përdoruesve aktivë në sistemet që ka në përdorim Bashkia Shkodër me të drejta në sistem sipas pozicioneve të punës. Pas analizimit dhe evidentimit të të gjithë përdoruesve, të merren masa për bllokimin e aksesit dhe ç'aktivizimin e të gjithë përdoruesve të cilët në bazë të vendimeve të Kryetarit të Bashkisë nuk janë më punonjës të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

20.2 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër, në bashkëpunim me strukturën e teknologjisë së informacionit të marrin masa për minimizimin e rasteve të krijimit të përdoruesve me kredenciale gjenerike. Nëse do të përdoren të tillë, të përcaktohet me Urdhër të veçantë se cili punonjës do të posedojë dhe do të përdorë këto kredenciale.

Në vijimësi

20.3 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër, në bashkëpunim me strukturën e teknologjisë së informacionit të marrin masa për aplikimin e certifikatave të sigurisë SSL (Secure Socket Layer) për SiTTV dhe SZ1N në web app.

Menjëherë dhe në vijimësi

20.4 Rekomandimi: Struktura e teknologjisë së informacionit, të marrin masa për bllokimin e mundësisë për aksesimin e SiTTV dhe SZ1N nga rrjeti Wifi i Bashkisë Shkodër.

Menjëherë

20.5 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Shkodër, në bashkëpunim me strukturën e teknologjisë së informacionit të marrin masa për hartimin dhe miratimin e një politike të mirë dokumentuar për analizimin periodik të gjurmëve të auditimit të veprimeve të kryera në sistemet IT me qëllim evidentimin dhe parandalimin e problematikave të mundshme në lidhje me mirëfunksionimin dhe mirë përdorimin e sistemeve IT të Bashkisë Shkodër.

Brenda datës 31 Dhjetor 2021 dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i bazës së të dhënave të Sistemit të Integruar të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Sistemit të Zyrës me Një Ndalesë u konstatua se këto dy sisteme kanë nevojë për përmirësime në drejtim të garantimit të integritetit dhe plotësisë së të dhënave që krijohen, menaxhohen dhe ruhen përmes tyre. Më konkretisht:

-Në Sistemin e Integruar i Taksave dhe Tarifave Vendore, janë konstatuar 5 problematika në lidhje me plotësinë e të dhënave përgjatë popullimit të tabelave dhe fushave;

-Në Sistemin e Zyrës me Një Ndalesë janë konstatuar 4 problematika: në lidhje saktësinë e fushave të populluara; në lidhje me statusin e aplikimeve për marrjen e shërbimeve; në lidhje me plotësinë e fushave, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (48-54) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

21.1 Rekomandimi: Struktura e teknologjisë së informacionit, të marrin masa për analizimin e situatës aktuale në lidhje me integritetin dhe plotësinë e të dhënave që përmbajnë sistemet informatike të Bashkisë Shkodër duke përcaktuar edhe shkaqet prej të cilëve rrjedhin problematikave të konstatuara. Të merren masat e nevojshme për ngritjen dhe implementimin e mekanizmave të kontrollit dhe validimit të inputit të sistemeve informatike, duke përcaktuar dhe kornizuar tipin e të dhënave që mund të plotësojnë përdoruesit në përputhje me formatin dhe informacionin që përmban secila prej fushave, me qëllim parandalimin e përsëritjes së problematikave të konstatuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT